



**PULSAR**

PERSPEKTIVAT PËR  
TË ARDHMEN

DOKUMENT TEKNIK

**Konsolidimi i  
pasqyrave financiare  
në nivele të ndryshme  
të qeverisjes**

© 2023 Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim / Banka Botërore  
1818 H Street NW,  
Uashington, D.K. 20433  
Telefon: 202-473-1000  
Internet: [www.worldbank.org](http://www.worldbank.org)

Ky dokument është produkt i stafit të Bankës Botërore, me kontribute të jashtme. Konstatimet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Bankës Botërore, Bordit të Drejtorëve Ekzekutivë të saj apo të qeverive që përfaqësojnë.

Banka Botërore nuk garanton saktësinë, plotësinë apo aktualitetin e të dhënave të përfshira në këtë punim dhe nuk merr përgjegjësi për gabime, mosparaqitje apo mospërputhje të informacioneve apo në lidhje me përdorimin apo mospërdorimin e informacioneve, metodave, proceseve apo përfundimeve të paraqitura në të. Kufijtë, ngjyrat, emërtimet dhe çdo informacion tjetër që paraqitet në hartat e këtij dokumenti nuk nënkuptojnë nga ana e Bankës Botërore asnjë gjykim për statusin juridik të asnjë territori dhe nuk përbëjnë ndonjë mbështetje apo pranim të kufijve të paraqitur.

Asgjë në këtë punim nuk mund të përbëjë apo të interpretohet apo të konsiderohet si kufizim apo heqje dorë nga privilegjet dhe imunitetet e Bankës Botërore, të cilat mbeten veçanërisht të rezervuara.

### **Të drejtat dhe lejimet**

Materialet e këtij dokumenti janë objekt i të drejtës së autorit. Duke qenë se Banka Botërore nxit shpërndarjen e njohurive të saj, ky dokument mund të riprodhohet, tërësisht ose pjesërisht, për qëllime jo komerciale, për sa kohë që është përmendur plotësisht titulli i këtij dokumenti.

Çdo kërkesë për të drejta dhe leje, përfshirë të drejtat dytësore, duhet t'i drejtohet Zyrës së Botimeve të Bankës Botërore, Grupi i Bankës Botërore, 1818 H Street NW, Uashington, D.K. 20433, SHBA; faks: 202-522-2625; e-mail: [pubrights@worldbank.org](mailto:pubrights@worldbank.org).

Ikonat janë krijuar nga noomtah, Freepik, Vector Stall dhe Afian Rochmah Afif nga Flaticon në [www.flaticon.com](http://www.flaticon.com)

Grafika e kopertinës: Kora Reichardt



Dokument teknik

# Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivele të ndryshme të qeverisjes

Dhjetor 2022

Fjalor i vogël .....	5
Falënderime .....	7
Parathënie .....	8
Përmbledhje e dokumentit .....	9
<b>1. HYRJE .....</b>	<b>11</b>
<b>1.1. Konteksti .....</b>	<b>11</b>
<b>1.2. Objektivi i dokumentit teknik .....</b>	<b>12</b>
<b>1.3. Motivet për përgatitjen e dokumentit teknik .....</b>	<b>12</b>
<b>1.4. Kufizimet e dokumentit teknik .....</b>	<b>13</b>
<b>1.5. Struktura e dokumentit teknik .....</b>	<b>13</b>
<b>2. KONSOLIDIMI DHE PËRPILIMI SIPAS SNKSP-VE DHE GFSM 2014 .....</b>	<b>14</b>
<b>2.1. Objekti i konsolidimit dhe përpilimit sipas SNKSP-ve dhe GFSM 2014 .....</b>	<b>14</b>
<b>2.2. Përvijimi i njësisë ekonomike sipas SNKSP-ve .....</b>	<b>20</b>
<b>2.3. Përvijimi i sektorit publik, sektorit të qeverisjes së përgjithshme dhe     nënsëktorëve të tyre sipas GFSM 2014 .....</b>	<b>22</b>
<b>2.4. Procesi i konsolidimit sipas SNKSP-ve .....</b>	<b>25</b>
2.4.1. Faza 1: Përgatitja fillestare, mirëmbajtja dhe puna përgatitore .....	25
2.4.1.1. Hapi 1: Përvijimi i njësisë ekonomike me anë të parimit të kontrollit .....	25
2.4.1.2. Hapi 2: Përdorimi i një plani kontabël të unifikuar dhe harmonizuar për të raportuar informacionin .....	26
2.4.1.3. Hapi 3: Përdorimi i të njëjtave politikave kontabël .....	26
2.4.1.4. Hapi 4: Përdorimi i të njëjtës datë ndarëse të pasqyrave financiare .....	26
2.4.1.5. Hapi 5: Zhvillimi dhe përditësimi i një sistemi ose algoritmi për konsolidimin .....	26
2.4.2. Faza 2: Konsolidimi i të dhënave financiare .....	27
2.4.2.1. Hapi 6: Mbledhja e të dhënave të njësive .....	27
2.4.2.2. Hapi 7: Verifikimi i përputhshmërisë së të dhënave të mbledhura .....	27

2.4.2.3. Hapi 8: Kryerja e rregullimeve të konsolidimit .....	27
2.4.2.4. Hapi 9: Verifikimi i rezultateve të përfuara .....	28
2.4.3. Faza 3: Raportimi financiar .....	28
2.4.3.1. Hapi 10: Nxjerrja e pasqyrës financiare të konsoliduar .....	28
<b>2.5. Procesi i përpilimit sipas GFSM 2014 .....</b>	<b>28</b>
<b>3. PËRVOJAT NDËRKOMBËTARE .....</b>	<b>30</b>
<b>3.1. Brazili .....</b>	<b>30</b>
3.1.1. Konteksti .....	30
3.1.2. Procesi i konsolidimit .....	31
3.1.3. Procesi i përpilimit .....	31
<b>3.2. Gjeorgjia .....</b>	<b>32</b>
3.2.1. Konteksti .....	32
3.2.2. Procesi i konsolidimit .....	33
3.2.3. Procesi i përpilimit .....	33
<b>3.3. Spain .....</b>	<b>34</b>
3.3.1. Konteksti .....	34
3.3.2. Procesi i konsolidimit .....	34
3.3.3. Procesi i përpilimit .....	35
<b>3.4. Zvicra .....</b>	<b>36</b>
3.4.1. Konteksti .....	36
3.4.2. Procesi i konsolidimit .....	36
3.4.3. Procesi i përpilimit .....	37
<b>3.5. Mësimet e nxjerra dhe praktikat e mira .....</b>	<b>38</b>
<b>4. PROCESI I INTEGRUAR I KONSOLIDIMIT DHE PËRPILIMIT .....</b>	<b>40</b>
<b>4.1. Faza 1: Përgatitja fillestare sipas kuadrit statistikor .....</b>	<b>42</b>
4.1.1. Hapi 1: Përvijimi i sektorit të qeverisjes së përgjithshme dhe sektorit publik dhe i nënsektorëve të tyre nëpërmjet klasifikimit sektorial .....	42
<b>4.2. Faza 2: Mirëmbajtja dhe puna përgatitore sipas standardeve të kontabilitetit dhe kuadrit statistikor .....</b>	<b>42</b>
4.2.1. Hapi 2: Përgatitja e një plani kontabël të harmonizuar me kuadrin kontabël dhe kuadrin statistikor .....	42
4.2.2. Hapi 3: Kujdesi për të përdorur të njëjtat politika kontabël .....	42

4.2.3. Hapi 4: Kujdesi për të përdorur të njëjtën datë ndarëse për pasqyrat financiare .....	43
4.2.4. Hapi 5: Zhvillimi dhe përditësimi i sistemeve ose lidhja e algoritmeve për konsolidimin dhe përpilimin .....	43
<b>4.3. Faza 3: Konsolidimi i të dhënave financiare sipas standardeve të kontabilitetit .....</b>	<b>43</b>
4.3.1. Hapi 6: Mbledhja e të dhënave të njëjta .....	43
4.3.2. Hapi 7: Verifikimi i përputhshmërisë së të dhënave të mbledhura .....	43
4.3.3. Hapi 8: Kryerja e rregullimeve të konsolidimit .....	44
4.3.4. Hapi 9: Verifikimi i rezultateve të përfuara .....	44
<b>4.4. Faza 4: Raportimi financiar sipas standardeve të kontabilitetit .....</b>	<b>44</b>
4.4.1. Hapi 10: Prodhimi i pasqyrës financiare të konsoliduar të sektorit publik, sektorit të qeverisjes së përgjithshme dhe të nënsektorëve të tyre .....	44
<b>4.5. Faza 5: Përpilimi i të dhënave statistikore .....</b>	<b>44</b>
4.5.1. Hapi 11: Kalimi nga të dhënat kontabël te ato statistikore .....	44
4.5.2. Hapi 12: Kryerja e rregullimeve statistikore .....	45
4.5.3. Hapi 13: Kontrolli i përputhshmërisë së GFS-ve të përpiluara .....	45
<b>4.6. Faza 6: Raportimi statistikor .....</b>	<b>45</b>
4.6.1. Hapi 14: Krijimi i produkteve statistikore .....	45
<b>5. PËRFUNDIME, REKOMANDIME, VËSHTIRËSI DHE MASA ZBUTËSE .....</b>	<b>46</b>
<b>5.1. Përfundime .....</b>	<b>46</b>
<b>5.2. Rekomandime .....</b>	<b>47</b>
<b>5.3. Vështirësitë dhe masat zbutëse .....</b>	<b>48</b>
<b>Shtojca 1. Pyetësi i dërguar vendeve për të mbledhur informacion .....</b>	<b>51</b>
<b>Pjesa 1: Procesi i konsolidimit të pasqyrave financiare .....</b>	<b>51</b>
<b>Pjesa 2: procesi i përpilimit të statistikave të financave të sektorit të qeverisjes së përgjithshme dhe sektorit publik .....</b>	<b>52</b>
<b>Shtojca 2. Sinteza e përvojave ndërkombëtare për përvijimin e objektivit të konsolidimit dhe përpilimit .....</b>	<b>53</b>
<b>Materialet mbështetëse .....</b>	<b>56</b>

## Lista e figurave

Figura 1. Objekti i konsolidimit sipas SNKSP-ve dhe përpilimit sipas GFSM 2014 .....	15
Figura 2. Listë jo shteruese e njësive të menduara për konsolidimin sipas SNKSP-ve dhe përpilimin sipas GFSM-së .....	16
Figura 3. Kriteret për vlerësimin e kontrollit sipas SNKSP 35 .....	21
Figura 4. Mënyra për vlerësimin e fuqisë sipas SNKSP 35 .....	21
Figura 5. Përvijimi i sektorit publik, sektorit të qeverisjes së përgjithshme dhe nënsektorëve të tyre sipas GFSM 2014 .....	24
Figura 6. Procesi i konsolidimit sipas SNKSP-ve .....	25
Figura 7. Procesi i përpilimit sipas GFSM 2014 .....	29
Figura 8. Procesi i integruar i konsolidimit dhe përpilimit .....	41

## Lista e tabelave

Tabela 1. Lista e njësive të menduara për konsolidimin dhe përpilimin në nivel qendror .....	18
Tabela 2. Vështirësi të mundshme dhe masat zbutëse në vënien në zbatim të procesit të integruar të konsolidimit dhe përpilimit që propozohet .....	48
Tabela 3. Konsolidimi në nivel qendror .....	53
Tabela 4. Përpilimi .....	54

# FJALOR I VOGËL

<b>AGE</b>	Administrata e Përgjithshme e Shtetit
<b>AKRP</b>	Agjencia Kombëtare e Regjistrimit Publik
<b>BFS</b>	Zyra Statistikore Federale
<b>BSNKSP</b>	Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
<b>CFC</b>	Këshilli Federal i Kontabilitetit i Brazilit
<b>DAMPPD</b>	Drejtoria për Analizë Makroekonomike dhe Planifikim të Politikave Fiskale
<b>EFD</b>	Ministria Federale e Financave
<b>EFV</b>	Administrata Federale e Financave
<b>ESA</b>	Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare dhe Rajonale
<b>Eurostat</b>	Zyra Statistikore e Bashkimit Evropian
<b>FMN</b>	Fondi Monetar Ndërkombëtar
<b>GFSM</b>	Manuali për Statistikat Financiare Qeveritare
<b>HRM2</b>	Modeli i Harmonizuar Kontabël për Kantonet dhe Komunitetet
<b>IC</b>	Ndër-shoqëri
<b>IGAE</b>	Kontrollori i Përgjithshëm i Administratës Shtetërore
<b>Ipea</b>	Instituti Brazilian i Shkencave të Zbatuara dhe Studimeve Ekonomike
<b>KP</b>	Komunitetet e Praktikës
<b>KP-E</b>	Komuniteti i Praktikës për Edukimin
<b>KP-RF</b>	Komuniteti i Praktikës për Kuadrin e Raportimit Financiar
<b>KSP</b>	Kontabiliteti në Sektorin Publik
<b>MFP</b>	Menaxhimi i financave publike
<b>Modeli SF</b>	Modeli i statistikave financiare
<b>Modeli SFQ</b>	Modeli i statistikave financiare qeveritare



<b>NJK</b>	Njësitë e konsolidimit
<b>NKSH</b>	Ndërmarrjet me kapital shtetëror
<b>NRM</b>	Modeli i Ri Kontabël i Konfederatës
<b>NSH</b>	Ndërmarrjet shtetërore
<b>PDT</b>	Procedura e deficitit të tejkaluar
<b>PK</b>	Plani kontabël
<b>PPKP</b>	Plani i Përgjithshëm i Kontabilitetit Publik
<b>PULSAR</b>	Kontabiliteti dhe raportimi në Sektorin Publik
<b>SAP BPC</b>	Planifikimi dhe Konsolidimi i Biznesit SAP
<b>SFQ</b>	Statistikat financiare qeveritare
<b>SIAFI</b>	Sistemi i Administrimit Financiar i Qeverisë Federale
<b>SICONFI</b>	Sistemi i Informacionit Kontabël dhe Fiskal për Sektorin Publik Brazilian
<b>SIIMF</b>	Sistemi i Integruar i Informacionit të Menaxhimit Financiar
<b>SJDP</b>	Subjekte juridike të së drejtës publike
<b>SJJT</b>	Subjekte juridike jo tregtare, jo ndërmarrje
<b>SML</b>	Fakulteti i Menaxhimit dhe së Drejtës
<b>SNKSP</b>	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
<b>SNRF</b>	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
<b>SQP</b>	Spektori i qeverisjes së përgjithshme
<b>STN</b>	Sekretariati i Thesarit të Shtetit
<b>TN</b>	Thesari i Shtetit
<b>ZHAW</b>	Universiteti i Shkencave të Aplikuara i Zyrihut



# FALËNDERIME

Ky material informativ është produkt i shkëmbimit të njohurive dhe bashkëpunimit mes anëtarëve të Komunitetit të Praktikës për Raportimin Financiar (KP-RF) të Programit për Kontabilitetin dhe Raportimin në Sektorin Publik (PULSAR). Ky raport u përgatit nga Dmitri Gourfinkel, specialist i lartë për menaxhimin financiar (Banka Botërore), me mbështetje nga Dr. Andreas Bergmann, Durlandy Cubillos dhe Maiara Sassos nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara i Zyrihut (ZHAW), nën drejtimin teknik të Daniel Boyce, Menaxher i Praktikës për Qeverisjen, dhe Arman Vatyan, kryespecialist për menaxhimin financiar (Banka Botërore). Faqosja e këtij produkti u bë nga Kora Reichardt (konsulentë e Bankës Botërore).

Ky material ka marrë kontribute edhe nga recensuesit e mëposhtëm: (i) Giuseppe Grossi, profesor kërkimor i Kontabilitetit pranë Universitetit "Nord" (Norvegji) dhe profesor i menaxhimit dhe kontabilitetit publik pranë Universitetit "Kristianstad" (Suedi); Jiwanka Wickramasinghe, specialiste e lartë për menaxhimin financiar (Banka Botërore); Juan Carlos Serrano, specialist i lartë për menaxhimin financiar (Banka Botërore); dhe Sage De Clerck, Ekonomiste e lartë (FMN).

Dëshirojmë të falënderojmë edhe ekspertët e mëposhtëm, për informacionet e vyera që na kanë dhënë: Renato Pucci dhe Heriberto do Nascimento (Sekretariati i Thesarit të Shtetit, Brazil), Davit Gamkrelidze (Ministria e Financave, Gjeorgji), Juan Báscones (Kontrollor i Përgjithshëm i Administratës Shtetërore, Spanjë), Alfredo Cristobal (Instituti Kombëtar i Statistikave, Spanjë), Stefan Berger dhe Florian Chatigny (Administrata Federale e Financave, Zvicër).

# PARATHËNIE

PULSAR, i filluar në vitin 2017, është një program në nivel rajoni dhe vendi me 13 vende përfituese në Evropë dhe Azinë Qendrore. Objektivi i programit është dhënia e mbështetjes për përmirësimin e kuadrit të kontabilitetit (SKP) dhe raportimit financiar në sektorin publik në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me praktikën e mira, në mënyrë që të rritet llogaridhënia, transparenca dhe ecuria e qeverive.

Objektivat dhe fushëveprimi i Programit PULSAR përcaktohen bashkërisht nga partnerët e Programit PULSAR – Austria, Zvicra dhe Banka Botërore – të cilët japin edhe mbështetjen institucionale për zbatimin dhe mobilizojnë burimet e nevojshme për aktivitetet. Vendet përfituese ndihmojnë në dhënien trajtë Programit PULSAR përmes platformave të bashkëpunimit rajonal dhe kontributeve në dy komunitetet e praktikës: Komuniteti i Praktikës për Raportimin Financiar (KP-RF) dhe Komuniteti i Praktikës për Edukimin (KPE).

KP-RF synon të mbështetë zyrtarët qeveritarë në menaxhimin e reformave të kontabilitetit të sektorit publik me anë të analizës së boshllëqeve, në hartimin e strategjive dhe udhërrëfyesve për reformën dhe në vënien në zbatim të përmirësimeve në fusha të tilla si legjislati, vendosja e standardeve, rregullimi dhe kontrolli i zbatimit dhe teknologjia informatike. Ky komunitet synon edhe përmirësimin e lidhjeve midis performancës financiare, menaxhuese dhe statistikore dhe raportimit buxhetor dhe zhvillimin e praktikave të mira dhe produkteve të dijes në përgjigje të sfidave të profesionistëve të identifikuar gjatë fuqizimit të kornizave të KSP-së.

Grupi kryesor i synuar i këtij dokumenti teknik mbi konsolidimin e pasqyrave financiare në nivele të ndryshme të qeverisjes janë ushtruesit e profesionit. Synimi është të informohen përmes identifikimit, kërkimit dhe propozimit të qasjeve të ndryshme të konsolidimit dhe përpilimit për pasqyrat financiare, përfshirë përvojat e vendeve të ndryshme dhe praktikën e mira ndërkombëtare. Përmes kësaj, evidenton disa sfida që kanë vënë re vendet në procesin e rakordimit dhe tregojnë si u kanë dhënë zgjidhje ato.

Grupi i dytë i synuar janë vendimmarrësit e politikave. Zbatimi i procesit të integruar të konsolidimit dhe përpilimit, që propozohet në këtë dokument teknik, mund të kuptohet si një vënie në zbatim të një politike publike e cila synon përmirësimin e menaxhimit të financave publike. Kjo mund të arrihet nëpërmjet rritjes së: i) besueshmërisë së informacioneve statistikore të përgatitura dhe paraqitura nga qeveritë; dhe ii) dobisë së informacioneve kontabël që përgatiten duke përdorur standarde cilësore. Ky dokument teknik propozon procesin dhe përshkruan hapat e nevojshëm që mund të jenë të dobishëm për hartimin e politikës publike.

Aspektet konceptuale kryesore të paraqitura në këtë dokument teknik ruajnë përputhshmëri me udhëzimet e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) dhe Manualit të Statistikave Financiare Qeveritare (GFSM) Megjithatë, rekomandohet që të konsultohen burimet origjinale lidhur me çështje teknike të veçanta.

# PËRMBLEDHJE E DOKUMENTIT

Objektivi kryesor i këtij dokumenti teknik është të identifikojë, përshkruajë dhe propozojë një proces të integruar për të ndihmuar në konsolidimin e pasqyrave financiare në sektorin publik dhe në përpilimin e statistikave financiare qeveritare (SFQ), duke mbajtur në konsideratë përvojat e vendeve dhe praktikave të mira ndërkombëtare nga Brazili, Gjeorgjia, Spanja dhe Zvicra. Përmes kësaj, dokumenti teknik evidenton disa sfida që kanë hasur vendet në procesin e rakordimit dhe mënyrat për t'u dhënë zgjidhje.

Procesi i integruar i konsolidimit dhe përpilimit, që propozohet, përdor përvijimin e sektorit publik dhe nënsektorëve të tij të paraqitur në GFSM 2014 për hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara, në vend të përvijimit të njësive ekonomike nëpërmjet parimit të kontrollit siç e kërkon SNKSP 35. Synimi i procesit të sugjeruar është të ndihmohet procesi i rakordimit mes kontabilitetit dhe GFS-së. Megjithatë, ky proces merr në konsideratë aspekte nga procesi i konsolidimit sipas SNKSP 35, të shpjeguara edhe në këtë dokument teknik.

Procesi i sugjeruar plotëson edhe ndërveprimin konceptual ndërmjet Kontabilitetit të Sektorit Publik (KSP) dhe statistikave financiare qeveritare (SFQ), e trajtuar në një prej dokumenteve teknike të PULSAR-it me titull "Udhëzues krahasimi: integrimi i kontabilitetit të sektorit publik dhe statistikave financiare shtetërore" (Udhëzuesi i Krahasimit) (Banka Botërore 2019).<sup>1</sup>

Mes dallimeve që e ndërllojnë procesin e rakordimit mes kontabilitetit dhe statistikave financiare qeveritare është objekti i konsolidimit të KSP-së dhe përpilimit të statistikave financiare qeveritare. Për shembull, sipas SNKSP-ve, konsolidimi i KSP-së përdor këndvështrimin ekonomik që mbështetet në parimin e kontrollit, duke e përcaktuar objektin e konsolidimit nëpërmjet grupimit të njësive kontrolluese dhe njësive të kontrolluara të saj në një njësi ekonomike.

Nga ana tjetër, sipas GFSM 2014, përpilimi i statistikave financiare qeveritare ndjek një këndvështrim statistikor dhe e përcakton objektin e përpilimit duke grupuar njësitë institucionale publike rezidente në sektorë dhe nënsektorë. Sektorët e përvijuar janë sektori publik, që përfshin qeverisjen e përgjithshme dhe sektorët e ndërmarrjeve publike. Sektori i qeverisjes së përgjithshme përfshin nënsektorët e qeverisjes në nivel qendror, nivel shteti dhe nivel lokal, ndërsa sektori i ndërmarrjeve publike përfshin nënsektorët e ndërmarrjeve publike jofinanciare dhe financiare.

Procesi i propozuar i konsolidimit dhe përpilimit ilustron në **Figurën 8** me katërmëdhjetë hapa të grupuar në gjashtë faza: i) përgatitja fillestare sipas kuadrit statistikor; ii) mirëmbajtja dhe puna përgatitore sipas standardeve të kontabilitetit dhe kuadrit statistikor; iii) konsolidimi i të dhënave financiare sipas standardeve të kontabilitetit; iv) raportimi financiar sipas standardeve të kontabilitetit; v) përpilimi i të dhënave statistikore; dhe vi) raportimi statistikor.

<sup>1</sup> Adresa ku gjendet teksti i plotë i Udhëzuesit të Krahasimit: <https://cfr.worldbank.org/publications/benchmarking-guide-integrated-psa-and-gfs>

Është mirë që zbatimi i procesit të sugjeruar të mbështetet në nevojat e secilit vend, por synimi është zvogëlimi i disa prej sfidave të vërejtura në procesin e përpilimit nga vendet e analizuara. Duke pasur parasysh dallimet konceptuale që ekzistojnë midis kuadrit kontabël dhe atij statistikor, mund të lindë nevoja për rregullime duke përdorur burime jo kontabël. Mirëpo, procesi i sugjeruar në këtë dokument teknik mund ta ulë numrin e rregullimeve të nevojshme dhe kompleksitetin e tyre.

Praktikat ndërkombëtare të përshkruara në këtë dokument teknik tregojnë se megjithëse të gjitha vendet e analizuara (Brazili, Gjeorgjia, Spanja dhe Zvicra) përdorin si kuadër kontabël SNKSP, drejtpërdrejt ose tërthorazi, vetëm dy prej tyre (Spanja dhe Zvicra) hartojnë pasqyra financiare të konsoliduara në nivel qendror në bazë të parimit të kontrollit. Dy vendet e tjera (Brazili dhe Gjeorgjia) e bëjnë me një qasje ligjore, në bazë të objektit të përcaktuar me ligj.

Nga ana tjetër, objekti i përpilimit të të gjitha vendeve të analizuara është përcaktuar duke përfshirë vetëm njësitë institucionale publike rezidente të cilat i përkasin sektorit të qeverisjes së përgjithshme dhe nënsektorët e saj (domethënë, qeverisja në nivel qendror/federal, shtetëror dhe lokal). Kjo do të thotë se nga katër vendet e analizuara, sektori publik nuk përpilon një raport financiar të konsoliduar si i tërë.

Objekti i konsolidimit mund të ndryshojë mes vendeve dhe varet nga nevojat për informacion të përdoruesve dhe nga standardet e zbatuara. Është po ashtu e mundshme që të ekzistojnë më shumë se një objekt dhe, për rrjedhojë, më shumë se një paketë pasqyrash financiare të konsoliduara, për t'iu përgjigjur nevojave të ndryshme për informacion.

Dokumenti teknik të çon edhe në përfundimin që, në njëfarë kuptimi, statistikave financiare qeveritare janë rezultat i një procesi konsolidimi; megjithëse, nuk zbatojnë konceptin e njësive ekonomike, por të sektorëve ekonomikë. Kjo lejon edhe zbatimin e çmuarjeve dhe rregullimeve statistikore dhe çon në një nivel më të lartë materialiteti në krahasim me pasqyrat financiare të njësisë ekonomike. Me fjalë të tjera, statistikave përfshijnë sektorë të tërë por janë më pak precize se pasqyrat financiare të konsoliduara.

Proceset e konsolidimit dhe përpilimit janë, për rrjedhojë, të ngjashme por jo identike. Si pasqyrat financiare të konsoliduara, ashtu edhe statistikave financiare qeveritare u përgjigjen nevojave konkrete për informacion që nuk përmbushen nga pasqyrat financiare individuale të njësive juridike. Ato paraqesin informacion ekonomik për njësi ekonomike dhe sektorë ekonomikë.

Në fund, ky dokument teknik identifikon një grup sfidash që mund të dalin gjatë zbatimit të procesit të sugjeruar të integruar të konsolidimit dhe përpilimit dhe strategji përkatëse për zgjidhjen e tyre, që paraqiten në fund të dokumentit (shih **Tabelën 2**). Sfidat kryesore janë: i) rregullimet ekzistuese kushtetuese dhe kërkesat ligjore; ii) një vëllim i madh njësish dhe operacionesh që duhen konsoliduar/përpiluar dhe mospërputhjet e mundshme mes të dhënave të marra; iii) përdorimi i politikave kontabël jo të njëjta dhe mungesë e një plani kontabël (PK) të unifikuar dhe harmonizuar për të raportuar informacionin; dhe iv) mungesë e një Sistemi të Integruar të Informacionit të Menaxhimit Financiar (SIIMF) ose një algoritmi urë për konsolidimin dhe përpilimin, mes të tjerash.

# 1

## HYRJE

### 1.1. Konteksti

1. Për përmirësimin e menaxhimit të financave publike (MFP) flitet prej më se 30 vjetësh – kur kjo temë mori rëndësi në fund të viteve '80 dhe fillim të viteve '90. Gjithashtu, kjo temë tërheq edhe më shumë vëmendje pasi ndodhin krizat, si pandemia e KOVID-19, dhe kur lind nevoja që vendi të ndjekë Objektivat e OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm.

2. Një sistem i mirë MFP-je është ai i cili mund të pasqyrojë saktë dhe besueshëm realitetin kompleks ekonomik të qeverive (Ball, 2020). Për ta arritur këtë, një prej dokumenteve teknike të PULSAR-it, "Udhëzues krahasimi: integrimi i kontabilitetit të sektorit publik dhe statistikave financiare shtetërore" (Banka Botërore, 2019), shtjellon ndërveprimin konceptual midis Kontabilitetit të Sektorit Publik (KSP) dhe Statistikave Financiare të Qeverisë (GFS).

3. Në ciklin e menaxhimit financiar të sektorit publik, KSP-ja siguron raportimin financiar që përdoret për përgatitjen e statistikave financiare qeveritare, pra prodhimi i statistikave financiare qeveritare kërkon një prurje të vazhdueshme të dhënash nga KSP-ja (Bergmann, 2009). Mirëpo, nevojitet një proces rakordimi për shkak të modeleve jo të njëjta bazë midis kornizave të përdorura në KSP dhe statistikave financiare qeveritare. Mes këtyre dallimeve janë objekti dhe procedurat. Sa i takon objektit, konsolidimi i KSP-së i hartuar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) përdorin një këndvështrim ekonomik të mbështetur në konceptin e kontrollit. Nga ana tjetër, përpilimi i statistikave financiare qeveritare sipas Manualit të Statistikave Financiare Qeveritare 2014 (GFSM 2014) ndjek një këndvështrim statistikor dhe e përcakton objektin e përpilimit duke grupuar njësitë institucionale publike rezidente në sektorë dhe nënsektorë.

4. Mirëpo, për shkak të organizimit kompleks të sektorit publik dhe gamës së gjerë të njësive të centralizuara dhe njësive në nivel poshtë nivelit qendror, kanë lindur këndvështrime të tjera nga objektet e përcaktuara nga kornizat ekzistuese ndërkombëtare të referimit. Për shembull, parimi i kontrollit i përcaktuar nga SNKSP-të përdoret në mënyrë më të ngushtë në këndvështrimin buxhetor objekti i konsolidimit i të cilit përfshin njësitet që kanë të bëjnë me buxhetin ose vendimet buxhetore të cilat janë me ndikim ose madje edhe me rëndësi kritike për to (Bergmann, 2009). Por nga një këndvështrim organizativ dhe ligjor, konsolidimi i KSP-së bëhet sipas strukturës organizative të përcaktuar me legjislacion (Bergmann, 2009).

## 1.2. Objektivi i dokumentit teknik

5. Objektivi kryesor i këtij dokumenti teknik është të identifikojë, përshkruajë dhe propozojë një proces të integruar për të ndihmuar në konsolidimin e pasqyrave financiare në sektorin publik dhe në përpilimin e statistikave financiare qeveritare, duke mbajtur në konsideratë përvojat e vendeve dhe praktikave të mira ndërkombëtare nga Brazili, Gjeorgjia, Spanja dhe Zvicra. Përmes kësaj, dokumenti teknik evidenton disa sfida që kanë hasur vendet në procesin e rakordimit dhe mënyrat për t'u dhënë zgjidhje.

## 1.3. Motivet për përgatitjen e dokumentit teknik

6. Përmirësimi i MFP-së mund të kuptohet në kuadër të shumë ideve të reja gjatë 30 a më shumë viteve të fundit. Ide të tilla kanë stimuluar, mes të tjerash, decentralizimin e shërbimeve për qytetarët. Decentralizimi, krahas strukturës organizative të

qeverive, kanë çuar në krijimin e një sërë njësish për ofrimin e shërbimeve. Njësitet të cilat bëjnë pjesë në këtë grup janë zakonisht të pavarura juridikisht por të varura ekonomikisht nga njësi të tjera. Rrjedhimisht, ekziston nevoja për të pasur instrumente kontabiliteti për të paraqitur pamjen financiare të njësive duke marrë në konsideratë njësitet të cilat janë ekonomikisht të varura. Një instrument kontabël i cili ndihmon në këtë aspekt janë pasqyrat financiare të konsoliduara.

7. Pasqyrat financiare të konsoliduara mundësojnë vlerësimin e performancës, rreziqeve buxhetore, detyrimeve dhe aktiveve të një grupi njësish si të ishin një njësi e vetme ekonomike. Për shkak të pamjes më të gjerë që mundësojnë pasqyrat financiare të konsoliduara, është praktikë e mirë hartimi dhe paraqitja e tyre. Standardet e kontabilitetit si SNKSP-të synojnë të japin informacion për llogaridhënien dhe vendimmarrjen, ndërsa kornizat statistikore sigurojnë shifra makroekonomike që kanë për qëllim të mbështetin analizën fiskale dhe bërjen e politikave. Për t'i arritur këta objektiva, standardet e kontabilitetit dhe kornizat statistikore kërkojnë hartimin dhe paraqitjen e informacioneve të konsoliduara ose të përpiluara. Megjithatë, objekti i konsolidimit është i ndryshëm.

8. Përkufizimi i objektit varet nga nevojat për informacion dhe standardet ose kornizat e zbatuara. Megjithatë, zakonisht qeveritë kanë procese më vete për zbatimin e standardeve ose kornizave të ndryshme, si SNKSP-të dhe GFSM 2014. Ky veçim sjell vështirësi të cilat mund ta pengojnë përmbylljen e kënaqshme të proceseve. Duke pasur parasysh këtë vështirësi dhe rëndësinë që ka të pasurit e informacioneve të konsoliduara ose të përpiluara, arsyeja për përgatitjen e këtij dokumenti teknik është të japë kontribut për trajtimin e vështirësive që hasin qeveritë nëpërmjet bashkimit të dy proceseve dhe vënies në zbatim të një procesi të integruar konsolidimi dhe përpilimi, që do të përmbushet standardet ose kornizat e ndryshme.

9. Krahas efikasitetit operativ që do të mund të arrihej me vënien në zbatim të procesit të propozuar, ai synon të japë kontribut në besueshmërinë e

informacioneve statistikore të hartuara dhe paraqitura nga qeveritë, duke qenë se raportet do të hartoheshin duke përdorur informacionet kontabël të sistemit të kontabilitetit të qeverisë dhe jo çmuarjet të cilat duhen përdorur në disa raste për shkak të mungesës së të dhënave. Gjithashtu, vënia në zbatim e një procesi të integruar konsolidimi dhe përpilimi do të mund ta përmirësonte dobinë e informacion kontabël që zakonisht hartohet me standarde të larta cilësore.

## 1.4. Kufizimet e dokumentit teknik

10. Ky dokument teknik plotëson punën e Udhëzuesit e Krahasimit.<sup>2</sup> Rrjedhimisht, rekomandohet që lexuesi të njihet paraprakisht me Udhëzuesin e Krahasimit, për të kuptuar më mirë këtë dokument teknik.

11. Në këtë dokument teknik, si edhe në Udhëzuesin e Krahasimit, autorët përdorin kornizat aktuale ndërkombëtare të referimit, që janë SNKSP-të dhe GFSM 2014, kur flasin për konsolidimin dhe përpilimin e të dhënave. Pra, ky dokument teknik, me përjashtim të pjesëve që raportojnë përvojën e vendeve, nuk mbulon rregullat e asnjë vendi dhe nuk synon të zëvendësojë asnjë kornizë kontabël apo statistikore.

## 1.5. Struktura e dokumentit teknik

12. Ky dokument përbëhet nga pesë krerë. Kreu 1 është hyrja, në të cilën paraqiten konteksti dhe motivet, si edhe jepen objektivi dhe kufizimet e këtij dokumenti teknik. Kreu 2 trajton tri tema: i. objekti i konsolidimit dhe përpilimit sipas SNKSP-ve dhe GFSM 2014; ii. përvijimi i njësisë ekonomike, sipas SNKSP-ve, dhe përvijimi i sektorit publik, sektorit të qeverisjes së përgjithshme dhe nënsektorëve të tyre, sipas GFSM 2014; dhe iii. procesi i konsolidimit dhe përpilimit, sipas kornizave kontabël dhe statistikore të lartpërmendura.

13. Kreu 3 paraqet përvojat ndërkombëtare për konsolidimin dhe përpilimin e të dhënave nga katër vende; Brazili, Gjeorgjia, Spanja dhe Zvicra. Në këtë krye jepet edhe shpjegimi metodik dhe përshkruhen mësimet e nxjerra nga të katër vendet, duke nënvizuar praktikatat e mira për hartimin dhe paraqitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara dhe përpilimin e statistikave financiare qeveritare.

14. Në Kreun 4 paraqitet propozimi për një proces të integruar konsolidimi dhe përpilimi. Prosesi i propozuar përfshin 14 hapa, të ndara në 6 faza. Në të, jepet edhe një shpjegim për secilin hap. Kreu 5 jep përfundimet e nxjerra dhe paraqet rekomandimet e mbështetura në SNKSP, GFSM 2014, përvojat e katër vendeve të përzgjedhura dhe autorët e këtij dokumenti teknik. Në këtë krye renditen edhe disa vështirësi të mundshme në vënien në zbatim të procesit që propozohet, dhe disa masa zbutëse.

<sup>2</sup> Adresa ku gjendet teksti i plotë i Udhëzuesit të Krahasimit: <https://cfr.worldbank.org/publications/benchmarking-guide-integrated-psa-and-gfs>



# 2

## KONSOLIDIMI DHE PËRPILIMI SIPAS SNKSP-VE DHE GFSM 2014

### 2.1. Objekti i konsolidimit dhe përpilimit sipas SNKSP-ve dhe GFSM 2014

15. SNKSP-të dhe GFSM 2014 përshkruajnë objektin e ndryshëm të konsolidimit dhe përpilimit. SNKSP-të mundësojnë hartimin dhe paraqitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara të njësisë ekonomike. Njësia ekonomike është një grup njësish që përfshin njësinë kontrolluese dhe çdo njësi të kontrolluar (SNKSP 35, paragrafi 16), edhe nëse ndodhen në territore të ndryshme ekonomike, siç tregohet në **Figurën 1**. Territori ekonomik është zona nën

kontrollin ekonomik efektiv të një qeverie të vetme (GFSM 2014 paragrafët 2.8 deri 2.11).


16. Në dallim nga SNKSP-të, GFSM 2014 mbështet përpilimin e statistikave për një ekonomi e cila përbëhet nga një bashkësi njësish institucionale rezidente (GFSM 2014, paragrafi 2.6). Për rrjedhojë, objekti i statistikave financiare të qeverisë përfshin sektorin publik, sektorin e qeverisjes së përgjithshme dhe nënsektorët e tyre (pra, nënsektorët e pushtetit qendror, shtetëror dhe vendor/lokal<sup>3</sup> dhe nënsektorët e ndërmarrjeve jofinanciare dhe financiare) por përfshin vetëm njësitë institucionale të cilat ndodhen në të njëjtin territor ekonomik, të quajtura njësi institucionale rezidente (GFSM 2014, paragrafët 1.4 dhe 2.63). Njësitë institucionale të cilat janë rezidente në çfarëdo territori ekonomik tjetër quhen jorezidente dhe përfshihen në të dhënat për pjesën tjetër të botës.

<sup>3</sup> Duhet thënë se fondet e sigurimeve shoqërore mund të paraqiteshin ose si nënsektor më vete i qeverisjes së përgjithshme, ose mund të përfshiheshin në nivelin e qeverisjes që i ka në kontroll këto фонде.

17. Enklavat territoriale, siç janë ambasadat, bazat ushtarake dhe stacionet shkencore mbeten pjesë e kompetencës së territorit ekonomik të cilit i shërbejnë dhe mbeten pjesë e territorit ekonomik A (shih **Figurën 1**). Në dallim nga kjo, ndërmarrjet shtetërore (NSH) (shpesh të quajtura ndryshe edhe ndërmarrje me kapital shtetëror) dhe shoqëritë e kontrolluara (filialet) të cilat nuk janë njësi institucionale rezidente, bëjnë pjesë në njësinë ekonomike në kuptim të kontabilitetit, sipas SNKSP-ve. Mirëpo, përfshihen gjithsesi në pjesën tjetër të botës për qëllime statistikore sipas GFSM 2014, duke qenë se këto NSH përfshihen në kompetencën e vendit pritës.

18. **Figura 1** tregon një shembull të objektit të konsolidimit dhe përpilimit sipas SNKSP-ve dhe GFSM 2014. Kjo figurë merr për bazë tri territore ekonomike: A, B dhe C. Territori ekonomik A përdoret për të përfaqësuar objektin e përpilimit sipas GFSM 2014, ndërsa territoret ekonomike B dhe C konsiderohen si pjesa tjetër e botës. Territori ekonomik A harton statistika financiare qeveritare për sektorin publik, sektorin e qeverisjes së përgjithshme dhe sektorin e ndërmarrjeve publike ku përfshihen të gjitha njësitë e saj institucionale rezidente publike. Territori ekonomik A harton statistika financiare qeveritare edhe për nënsektorët e qeverisjes në nivel qendror, nivel

**Figura 1.** Objekti i konsolidimit sipas SNKSP-ve dhe përpilimit sipas GFSM 2014



**Legjenda:**

- Kjo trajtë tregon një njësi institucionale publike rezidente të territorit ekonomik A.
- △ Kjo trajtë tregon një njësi institucionale publike jo rezidente të territorit ekonomik A.
- Kjo ngjyrë tregon një njësi kontrolluese sipas parimit të kontrollit të SNKSP 35.

- Kjo ngjyrë tregon njësitë e kontrolluara sipas parimit të kontrollit të SNKSP 35.
- Drejtkëndori i formuar me këtë vijë tregon njësinë ekonomike e cila integron një pasqyrë financiare të konsoliduar sipas SNKSP-ve.
- Drejtkëndorët e formuar me këtë vijë tregojnë sektorët dhe nënsektorët e tyre të cilët integrojnë përpilimin sipas GFSM 2014.

Burimi: Ekipi i Bankë Botërore, mbështetur në SNKSP 35 dhe GFSM 2014.

shteti dhe nivel vendor të sektorit të qeverisjes së përgjithshme dhe nënsektorët e ndërmarrjeve publike financiare dhe jofinanciare.

19. Sa i takon objektit të konsolidimit, **Figura 1** tregon vetëm një shembull të një njësie ekonomike sipas përkufizimit të SNKSP 35. Njësia kontrolluese i përket nënsektorit të qeverisjes qendrore të territorit ekonomik A, por njësitë e kontrolluara të saj u përkasin territoreve të ndryshme ekonomike. Ka dy njësi të kontrolluara në territorin ekonomik A: njëra syresh klasifikohet në të njëjtin nënsektor të njësisë kontrolluese, pra në nënsektorin e qeverisjes qendrore, ndërsa tjetra në nënsektorin e ndërmarrjeve publike jofinanciare. Ka edhe tri njësi të

kontrolluara të cilat ndodhen në territoret ekonomike B dhe C, pra në pjesën tjetër të botës. Shembuj të tjerë njësi kontrolluese mund të identifikohen në çdo sektor dhe nënsektor të territorit ekonomik A dhe këto duhet të marrin në konsideratë edhe çdo njësi të kontrolluar që ndodhet në pjesën tjetër të botës.

20. Brenda secilit nënsektor të sektorit të qeverisjes së përgjithshme (pra në nivel qendror, nivel shteti dhe nivel vendor) dhe të çdo sektori të ndërmarrjeve publike (pra, jofinanciare dhe financiare), mund të marrin pjesë njësi të ndryshme. Për disa shembuj njësisish që zakonisht merren në konsideratë në konsolidim sipas SNKSP-ve dhe përpilim sipas GFSM 2014, **Figura 2** jep një listë jo shteruese të tyre.

**Figura 2.** Listë jo shteruese e njësive të menduara për konsolidimin sipas SNKSP-ve dhe përpilimin sipas GFSM-së

Konsolidimi sipas SNKSP-ve	Listë joshteruese e njësive	Përpilimi i SFQ-ve
Brenda njësisë ekonomike të përvijuar, nëse kontrollohet nga njësia kontrolluese e përcaktuar	Ministritë, përfshirë njësitë e qeverisjes të decentralizuara pa personalitet juridik	Brenda SQP-së si pjesë e nënsektorit (pra, nënsektorët e qeverisjes në nivel qendror, shteti ose vendor) që integron
Brenda njësisë ekonomike të përvijuar, nëse kontrollohet nga njësia kontrolluese e përcaktuar, pavarësisht nëse janë njësi institucionale rezidente ose jo	Njësi të qeverisjes të decentralizuara jo krijuese të tregut, me personalitet juridik (p.sh., agjenci)	Brenda SQP-së si pjesë e nënsektorit (pra, nënsektorët e qeverisjes në nivel qendror, shteti ose vendor) që integron, nëse janë njësi institucionale rezidente
Pavarësisht nëse janë njësi institucionale rezidente ose jo, brenda njësisë ekonomike, nëse kontrollohen nga njësia kontrolluese e vendosur	Njësi të qeverisjes të decentralizuara krijuese të tregut, me personalitet juridik (p.sh., agjenci)	Brenda sektorit të ndërmarrjeve publike si pjesë e nënsektorit (pra nënsektorët jofinanciarë ose financiarë) që integron, nëse janë njësi institucionale rezidente
Brenda njësisë ekonomike, nëse kontrollohet nga njësia kontrolluese e vendosur	Parlamenti dhe njësi të tjera të legjislativit	Brenda SQP-së si pjesë e nënsektorit (pra, nënsektorët e qeverisjes në nivel qendror, shteti ose vendor) që integron
Brenda njësisë ekonomike, nëse kontrollohet nga njësia kontrolluese e vendosur	Njësitë e gjyqësorit	Brenda SQP-së si pjesë e nënsektorit (pra, nënsektorët e qeverisjes në nivel qendror, shteti ose vendor) që integron

## Konsolidimi sipas SNKSP-ve

## Listë joshteruese e njësive

## Përpilimi i SFQ-ve

Brenda njësisë ekonomike të përvijuar, nëse kontrollohet nga njësia kontrolluese e përcaktuar, pavarësisht nëse janë njësi institucionale rezidente ose jo

NSH jo krijuese të tregut (qeveria zotëron  $\geq 50\%$ )

Brenda SQP-së si pjesë e nënsektorit (pra, nënsektorët e qeverisjes në nivel qendror, shteti ose vendor) që integron, nëse janë njësi institucionale rezidente dhe kontrollohen nga sektori publik

Brenda njësisë ekonomike të përvijuar, nëse kontrollohet nga njësia kontrolluese e përcaktuar, pavarësisht nëse janë njësi institucionale rezidente ose jo

NSH krijuese të tregut (qeveria zotëron  $\geq 50\%$ )

Brenda sektorit të ndërmarrjeve publike si pjesë e nënsektorit (pra nënsektorët jofinanciarë ose financiarë) që integron, nëse janë njësi institucionale rezidente dhe kontrollohen nga sektori publik

Brenda njësisë ekonomike të përvijuar, nëse kontrollohet nga njësia kontrolluese e përcaktuar, pavarësisht nëse janë njësi institucionale rezidente ose jo

Ndërmarrje me kapital të përzier (qeveria zotëron  $< 50\%$ )

Brenda sektorit të ndërmarrjeve publike si pjesë e nënsektorit (pra nënsektorët jofinanciarë ose financiarë) që integron, nëse janë njësi institucionale rezidente dhe kontrollohen nga sektori publik

Brenda njësisë ekonomike të përvijuar, nëse kontrollohet nga njësia kontrolluese e përcaktuar

Njësitë e qeverisjes në nivel shteti

Brenda SQP-së si pjesë e një prej nënsektorëve të tij

Brenda njësisë ekonomike të përvijuar, nëse kontrollohet nga njësia kontrolluese e përcaktuar

Njësitë e qeverisjes vendore

Brenda SQP-së si pjesë e një prej nënsektorëve të tij

Brenda njësisë ekonomike të përvijuar, nëse kontrollohet nga njësia kontrolluese e përcaktuar

Fondet e sigurimeve shoqërore

Brenda SQP-së si pjesë e nënsektorit (pra, nënsektorët e qeverisjes në nivel qendror, shteti ose vendor) që integron ose brenda SQP-së si një nënsektor i pavarur, sipas praktikës së vendit

Brenda njësisë ekonomike të përvijuar, nëse kontrollohet nga njësia kontrolluese e përcaktuar

Banka qendrore

Brenda sektorit të ndërmarrjeve publike si pjesë e nënsektorit financiar

Brenda njësisë ekonomike të përvijuar, nëse kontrollohet nga njësia kontrolluese e përcaktuar, pavarësisht nëse janë njësi institucionale rezidente ose jo dhe nëse janë krijues tregu ose jo

Universitetet

Brenda SQP-së si pjesë e nënsektorit (pra, nënsektorët e qeverisjes në nivel qendror, shteti ose vendor) që integron, nëse janë njësi institucionale rezidente dhe jo krijues tregu. Përndryshe, si pjesë e pjesës tjetër të botës ose e ndërmarrjeve publike

Burimi: Ekipi i Bankës Botërore.

21. Duke pasur parasysh **Figurën 2**, njësitë të cilat do të merreshin në konsideratë gjatë konsolidimit sipas SNKSP-ve dhe gjatë përpilimit sipas GFSM 2014 në nivel qendror në vendet me paraqiten në **Tabelën 1**.

Në funksion të përpilimit në nivel qendror sipas GFSM 2014, njësitë e përfshirë nuk ndryshojnë sipas sistemit të qeverisjes.

**Tabela 1.** Lista e njësive të menduara për konsolidimin dhe përpilimin në nivel qendror

Sistemet e qeverisjes	Lista e njësive	Klasifikimi i njësive sipas:		Konsolidimi	Përpilimi		
		Rezidente <sup>4</sup>	Krijues tregues <sup>5</sup>		Sektori i qeverisjes së përgjithshme	Sektori i ndërmarrjeve publike	Sektori publik
Vend federal dhe unitar i centralizuar ose i decentralizuar	Ministritë, përfshirë njësitë qeveritare të decentralizuara pa personalitet juridik	Rezidente	Jo	Po	Po	Jo	Po
	Njësi të qeverisjes së decentralizuar me personalitet juridik (p.sh. agjenci)	Rezidente	Jo	Po	Po	Jo	Po
			Po	Po	Jo	Po	Po
		Jo-rezidente	Jo ose Po	Po	Jo	Jo	Jo
	Parlamenti dhe njësi të tjera të legjislativit dhe gjyqësorit	Rezidente	Jo	Po	Po	Jo	Po
	NSH (qeveria zotëron >= 50%)	Rezidente	Jo	Po*	Po*	Jo	Po*
			Po	Po*	Jo	Po*	Po*
		Jo-rezidente	Jo ose Po	Po*	Jo	Jo	Jo
	Ndërmarrje me kapital të përzier (qeveria zotëron <50%)	Rezidente	Jo	Po*	Po*	Jo	Po*
			Po	Po*	Jo	Po*	Po*
Jo-rezidente		Jo ose Po	Po*	Jo	Jo	Jo	

<sup>4</sup> Rezidenca e një njësie institucionale duhet të identifikohet për qëllime të përpilimit të statistikave financiare qeveritare. Njësitë institucionale mund të jenë rezidente ose jorezidente. Rezidente është njësia e cila qendrën e interesit kryesor ekonomik e ka në territorin ekonomik të analizuar. Jorezidente është njësia që është rezidente në çfarëdo territor tjetër ekonomik, që quhet pjesa tjetër e botës (GFSM 2014).

<sup>5</sup> Njësia institucionale mund të jetë krijues tregu ose jo krijues tregu dhe ky klasifikim kërkohet për përpilimin e statistikave financiare qeveritare. një njësi jo krijuese tregu ua jep të gjithin ose shumicën e produktit të vet njësive të tjera, pa pagesë ose me çmime që janë të parëndësishme ekonomikisht. Një njësi krijuese tregu ua jep të gjithin ose shumicën e produktit të vet njësive të tjera me çmime që janë të rëndësishme ekonomikisht (GFSM 2014, paragrafi 2.65).

Sistemet e qeverisjes	Lista e njësive	Klasifikimi i njësive sipas:		Konso- lidimi	Përpilimi		
		Rezidente <sup>4</sup>	Krijues tregue <sup>5</sup>		Sektori i qeverisjes së përgjith- shme	Sektori i ndërma- rrjeve publike	Sektori publik
	Fondet e sigurimeve shoqërore	Rezidente	Jo	Po*	Po	Jo	Po
	Banka Qendrore	Rezidente	Po	Po*	Jo	Po	Po
	Universitetet kombëtare	Rezidente	Jo	Po*	Po	Jo	Po
			Po	Po*	Jo	Po	Po
		Jo- rezidente	Jo ose Po	Po*	Jo	Jo	Jo
	Vend federal dhe unitar i decentralizuar	Qeverisja në nivel shteti dhe në nivel vendor	Rezidente	Jo	Jo	Po	Jo
Universitetet rajonale/vendore		Rezidente	Jo	Jo	Po	Jo	Po
			Po	Jo	Jo	Po	Po
		Jo- rezidente	Jo ose Po	Jo	Jo	Jo	Jo
Vend unitar i centralizuar	Qeverisja në nivel shteti dhe në nivel vendor	Rezidente	Jo	Po*	Po	Jo	Po
	Universitetet rajonale/vendore	Rezidente	Jo	Po*	Po	Jo	Po
			Po	Po*	Jo	Po	Po
		Jo- rezidente	Jo ose Po	Po*	Jo	Jo	Jo

\* Nëse kontrollohet nga qeverisja qendrore.

Burimi: Ekipi i Bankës Botërore.

22. Por, në funksion të konsolidimit në nivel qendror sipas SNKSP-ve, nuk ka dallime të lidhura me qeverisjen nën nivelin qendror dhe universitetet midis vendeve me sistem unitar të centralizuar dhe vendeve me sistem federal ose unitar të decentralizuar. Dallimi ndodh për shkak të faktit se në vendet me sistem unitar të centralizuar, qeveria qendrore

është autoriteti i lartë, ndërsa njësitë e qeverisjes nën nivelin qendror dhe njësitë e tyre zakonisht kontrollohen nga qeverisja qendrore. Nga ana tjetër, në vendet me sistem federal ose me sistem unitar të decentralizuar, njësitë e qeverisjes nën nivelin qendror janë autonome dhe ato, bashkë me njësitë e tyre, nuk kontrollohen nga niveli qendror.

23. Sipas SNKSP-ve, përvijimi i njësisë ekonomike bëhet duke vlerësuar dhe zbatuar parimin e kontrollit. Ky parim thotë se një njësi e kontrollon një njësi tjetër nëse përmbushen të gjitha kriteret e mëposhtme: i. njësia ushtron fuqi mbi njësinë tjetër; ii. njësia është e ekspozuar, ose ka të drejta, ndaj përfitimeve të ndryshueshme nga përfshirja e saj me njësinë tjetër; dhe iii. njësia e ka mundësinë për të përdorur fuqinë e saj mbi njësinë tjetër për të ndikuar në natyrën ose shumën e përfitimeve nga përfshirja e saj me njësinë tjetër (SNKSP 35, paragrafi 20). Këto kritere paraqiten në **Figurën 3** dhe diskutohen me hollësi në **Pjesën 2.2**.

24. Ndërkohë që SNKSP-të përdorin parimin e kontrollit, GFSM 2014 marrin në konsideratë objektivat, funksionet, sjelljen dhe kontrollin e një grupi njësish institucionale për të përvijuar sektorin e qeverisjes së përgjithshme, sektorin publik dhe nënsektorët e tyre. Sektori i qeverisjes së përgjithshme përfshin njësitë institucionale publike të cilat kryejnë veprimtari jo tregu dhe përmbushin funksionet e qeverisjes si veprimtari parësore të tyre. Sektori publik përfshin vetë sektorin e qeverisjes së përgjithshme dhe njësitë e tjera publike institucionale që kryejnë veprimtari tregu, të quajtura ndërmarrje publike (GFSM 2014, paragrafi 1.2). Hollësi të mëtejshme mbi përvijimin e këtyre sektorëve dhe nënsektorëve të tyre diskutohen në **Pjesën 2.3**.

## 2.2. Përvijimi i njësisë ekonomike sipas SNKSP-ve

25. Sipas SNKSP-ve, përvijimi i njësisë ekonomike sipas parimit të kontrollit kërkon, së pari, të kuptuarit saktë organizimin dhe operacionet e sistemit qeveritar, në bazë të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore të çdo vendi (SNKSP 35, paragrafi 17).

26. Është e nevojshme të vlerësohet nëse qeveria, nëpërmjet njësive ose subjekteve të veta, ka nën kontroll njësi të tjera, përfshirë njësitë e qeverisjes në nivelin qendror, sipas rastit. Për të kryer këtë vlerësim, kërkohet të qartësohet nëse qeveria përmbush tri kriteret e parimit të kontrollit të paraqitura në **Figurën 3**, pra nëse qeveria ka fuqi mbi njësitë e tjera; qëndron e ekspozuar, ose ka të drejta, në përfitime të ndryshueshme nga angazhimi; dhe është në gjendje ta

përdorë fuqinë e vet mbi njësinë tjetër për të ndikuar në natyrën ose vlerën e këtyre përfitimeve. Duhet thënë se sipas SNKSP-ve, koncepti i kontrollit nuk e përfshin kontrollin rregullator.


27. Për të përcaktuar nëse qeveria ka fuqi mbi një njësi, duhet të verifikohet nëse kjo qeveri apo një palë e lidhur e përcaktuar sipas SNKSP 20, gëzon të drejta të cilat i japin mundësi të ndikojë në aktivitetet përkatëse të asaj njësie. Aktivitetet përkatëse janë ato që ndikojnë ndjeshëm në natyrën ose shumën e përfitimeve që një njësi merr nga përfshirja e saj me njësinë nën shqyrtim (SNKSP 35, paragrafët 14 dhe 23). Janë zakonisht ato aktivitete të cilat kontribuojnë në misionin e njësisë (për shembull, shërbimet shëndetësore në rastin e një spitali).

28. Megjithëse të drejtat janë në formën e të drejtave të votës të dhëna nga instrumentet e kapitalit (për shembull, aksionet), në sektorin publik është me rëndësi të merren në konsideratë edhe të drejta të tjera, siç janë ato që rrjedhin nga rregullime detyruese (siç janë autoriteti legjislativ ose ekzekutiv, rregullimet administrative ose kontraktore, dokumentet e themelimit si statuti) (SNKSP 35, paragrafi 24), siç tregohet në **Figurën 4**.

29. Mes të drejtave, krahas të drejtave të votës, të cilat veçmas ose bashkërisht mund t'i japin një njësie fuqi mbi një njësi tjetër, përfshihen të drejtat: i. për t'i dhënë udhëzime mbi politikat organit të saj drejtues; ii. për të caktuar, transferuar ose hequr funksionarët kryesorë drejtues të cilët janë në gjendje të udhëzojnë aktivitetet përkatëse të saj; iii. për të emëruar dhe larguar një tjetër njësi e cila udhëzon aktivitetet përkatëse të saj; iv. për të miratuar ose për të vendosur veton mbi buxhetin e lidhur me aktivitetet përkatëse të saj; v. për të udhëzuar ose për të vendosur veton për kryerjen nga njësia tjetër të veprimeve ose për kryerjen e ndryshimeve të saj në përfitim të vetes; dhe vi. për të vendosur veton mbi ndryshimet kyçe në njësinë tjetër, siç është disponimi i një aktivi madhor apo i njësisë tjetër në tërësi (SNKSP 35, paragrafi AG17).


30. Krahas kësaj, mund të jetë e nevojshme të shqyrtohen fakte ose rrethana të tjera të cilat, së bashku me të drejta të tjera, mund të tregojnë fuqi, të tilla si: i. ekzistenca e një marrëdhënieje varësie ndërmjet njësisë dhe një njësie tjetër (për shembull, funksionimi i njësisë tjetër varet nga fonde, dorëzani, shërbime, aktive ose funksionarë kyç drejtues të njësisë); ii. një përqindje e konsiderueshme e

Figura 3. Kriteret për vlerësimin e kontrollit sipas SNKSP 35



Burimi: Ekipi i Bankës Botërore, mbështetur në SNKSP 35

Figura 4. Mënyra për vlerësimin e fuqisë sipas SNKSP 35



Burimi: Ekipi i Bankës Botërore, mbështetur në SNKSP 35



aktiviteteve të njësisë tjetër përfshijnë njësinë ose kryhen për llogari të saj; iii. ekspozimi ose të drejtat e njësisë në përfitimet nga pjesëmarrja ose përfshirja e saj në njësinë tjetër është në përpjesëtim të zhdrejtë më e madhe se të drejtat e saj të votës ose të drejta të tjera të ngjashme të saj (SNKSP 35, paragrafi AG21).

31. Për të përcaktuar nëse qeveria mban ekspozim ose të drejta në përfitime të ndryshueshme nga përfshirja e saj në një njësi tjetër, SNKSP-ja sugjeron të qartësohet nëse përfitimet që ajo kërkon nga përfshirja e saj kanë potencialin të ndryshojnë si rezultat i performancës së njësisë tjetër (SNKSP, paragrafi 30). Këto përfitime mund të jenë financiare ose jofinanciare dhe ndikimi i tyre mund të ketë aspekte pozitive ose negative (SNKSP 35, paragrafi 14).

32. Përfitimet financiare janë avantazhe të cilat qeveria i merr nga përfshirja e saj në njësinë që vlerësohet dhe të cilat mund të maten në formë financiare. Të tilla mund të jenë fitimet nga investimi si dividendët ose shpërndarjet e ngjashme; kursimet në kosto; interesat e mbetur në aktivet neto të asaj njësie tjetër nga likuidimi dhe humbjet për shkak të marrëveshjeve për mbështetje financiare; realizimi i rreziqeve në projekte madhore; dhe luhatjet në vlerën e investimeve (SNKSP, paragrafët 31 dhe 32).

33. Nga ana tjetër, përfitimet jofinanciare përfshijnë ato avantazhe të cilat nuk mund të maten në formë financiare dhe përfitimet ekonomike të marra drejtpërdrejt nga marrësit e shërbimeve që ofron qeveria. Ato merren kryesisht kur aktivitetet e njësisë nën shqyrtim janë në harmoni të plotë me objektivat e qeverisë dhe, rrjedhimisht, e mbështesin qeverinë në arritjen e objektivave të saj, ose kur njësi nën shqyrtim ka objektiva plotësues me objektivat e qeverisë dhe, rrjedhimisht, u shtojnë dhe i bëjnë më të plotë këta objektiva (SNKSP 35, paragrafi 31).

34. Shembuj të përfitimeve jofinanciare të cilat qeveria mund t'i marrë nga përfshirja e saj me njësinë nën shqyrtim përfshijnë rritje të efikasitetit dhe efektivitetit të prodhimit dhe ofrimit të mallrave dhe shërbimeve, aftësinë për të përfituar nga njohuritë e specializuara të njësisë tjetër, përmirësimin e rezultateve, përfitimn e aktiveve, realizimin e shërbimeve të lidhura më herët nga sa do të pritej përndryshe dhe një nivel më të lartë të cilësisë së shërbimit sesa do të ndodhte ndryshe (SNKSP 35, paragrafi 33).

35. Sa i takon ndryshueshmërisë së përfitimeve financiare dhe jofinanciare, SNKSP-ja sugjeron se

vlerësimi duhet bërë në bazë të përmbajtjes dhe jo të formës juridike të përfitimeve. Për shembull, përfitimet jofinanciare që rrjedhin nga aktivitetet e njësisë që vlerësohet prej të cilave përfiton arritja e objektivave të qeverisë mund të konsiderohen të ndryshueshme sepse këto përfitime janë të ekspozuara ndaj rrezikut të performancës së asaj njësie tjetër. Po kështu, përfitimet financiare që lindin nga instrumenti i borxhit të mbajtur nga qeveria, që paguan interes fiks, mund të konsiderohen të ndryshueshme duke qenë se janë objekt i rrezikut të kredisë së njësisë nën vlerësim (SNKSP 35, paragrafi AG58).

36. Për të parë nëse qeveria mund ta përdorë fuqinë e saj mbi një njësi tjetër për të ndikuar në natyrën ose shumën e përfitimeve nga përfshirja e saj me njësinë tjetër, është e nevojshme të vlerësohet nëse qeveria mund ta drejtojë atë njësi tjetër që të punojë me të për të çuar përpara objektivat e qeverisë. Në këtë vlerësim, është e mundshme që një tjetër njësi me të drejta vendimmarrjeje të veprojnë si agjent për qeverinë. Edhe në këtë rast, nëse fuqia mbahet dhe ushtrohet nga agjenti, veprimet kryhen për llogari dhe përfitim të qeverisë, që vepron si palë kryesore (SNKSP 35, paragrafët 35-37).

## 2.3. Përvijimi i sektorit publik, sektorit të qeverisjes së përgjithshme dhe nënsektorëve të tyre sipas GFSM 2014

37. Sipas GFSM 2014, statistikat duhen përpiluar për sektorin publik, sektorin e qeverisjes së përgjithshme, sektorin e ndërmarrjeve publike, si edhe për të gjithë nënsektorët që përbëjnë sektorët e qeverisjes së përgjithshme dhe të ndërmarrjeve publike (GFSM 2014, paragrafi 2.63). Përvijimi i këtyre sektorëve dhe nënsektorëve kërkon, pikë së pari, identifikimin e të gjitha njësive institucionale rezidente të kontrolluara drejtpërdrejt ose tërthorazi nga njësitë rezidente të qeverisjes dhe të dalluarit e tyre nga filialet artificiale. Njësitë e identifikuara kështu quhen njësi institucionale të sektorit publik.

38. Njësia institucionale është një njësi ekonomike e cila është e aftë të zotërojë aktive, të marrë detyrime, të angazhohet në aktivitete ekonomike/transaksione me njësi të tjera dhe të ndërtojë një paketë të plotë pasqyrash financiare përfshirë pasqyrën e bilancit (GFSM 2014, paragrafët 2.22 dhe 2.126). Identifikimi i njësive institucionale ka rëndësi për hartimin e statistikave financiare qeveritare sipas GFSM 2014, sepse mundëson sektorizimin e ekonomisë, identifikimin e kundërpalës së transaksioneve dhe pozicioneve të inventarit dhe përpilimin (GFSM 2014, paragrafi 2.23).

39. Sikurse përmendet në **Pjesën 2.1**, përpilimi i statistikave sipas GFSM 2014 mbulon vetëm njësitë institucionale të sektorit publik të cilat janë rezidente të një territori ekonomik, që përputhet me korniza të tjera statistikore ndërkombëtare. Njësitë institucionale të cilat janë rezidente në një territor ekonomik tjetër quhen jorezidente dhe klasifikohen në pjesën tjetër të botës. Rezidenca e njësisë institucionale mbështetet në territorin ekonomik me të cilin ka lidhje më të fortë dhe nuk përcaktohet në bazë të shtetësisë apo të kriterëve ligjore (GFSM 2014, paragrafi 2.7).

40. GFSM 2014 e përshkruan territorin ekonomik si një zonë gjeografike ose juridikson nën kontrollin efektiv të një qeverie unike, përfshirë sipërfaqen tokësore, hapësirën ajrore, ujërat territoriale dhe enklavat territoriale në pjesën tjetër të botës. Mirëpo, ky manual sugjeron gjithashtu se mund të jetë më i madh ose më i vogël se territori i përcaktuar nga kufijtë e tij fizikë ose politikë, siç është rasti i një bashkimi monetar apo ekonomik, apo si pjesë e një ekonomie, rajoni apo botës në tërësi (GFSM 2014, paragrafët 2.8 dhe 2.9).

41. Sa i takon filialit artificial, GFSM 2014 e përcakton si një njësi e cila, edhe pse ka identitet juridik më vete, nuk është e aftë të veprojë në mënyrë të pavarur nga mëma dhe është mbajtëse pasive e aktiveve dhe detyrimeve (GFSM 2014, paragrafi 2.42). Në përpilimin e statistikave, filialet artificiale nuk konsiderohen njësi institucionale dhe duhen klasifikuar si pjesë përbërëse të njësive mëmë të tyre, përveçse kur janë rezidente në një ekonomi tjetër nga ekonomia e njësisë mëmë, rast në të cilin duhen futur në pjesën tjetër të botës.

42. Së dyti, është e nevojshme të klasifikohen njësitë e sektorit publik që janë krijues tregu si ndërmarrjet publike dhe ato që nuk janë krijues tregu si njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Sipas GFSM 2014, një krijues tregu ua jep të gjithin ose shumicën e produktit

të vet të tjerave me çmime që janë të rëndësishme ekonomikisht në dallim nga një njësi jo krijuese tregu që ua jep pa pagesë ose me çmime që janë të parëndësishme ekonomikisht (GFSM 2014, paragrafi 2.65).


43. Në ndarjen midis krijuesit të tregut dhe jo krijuesit të tregut, duhet mbajtur parasysh edhe se nëse një njësi e qeverisjes së përgjithshme ka një vendosje jo të themeluar si shoqëri e cila faturon çmime me rëndësi ekonomike dhe nëse përmbush kriteret për të qenë njësi institucionale më vete, duhet konsideruar si thujse shoqëri tregtare dhe të klasifikohet në sektorin e ndërmarrjeve publike. Vendosjet e tjera do të mbeteshin pjesë integrale e njësisë së qeverisjes së përgjithshme (GFSM 2014, paragrafi 2.75).

44. Së treti, është e nevojshme të klasifikohen ndërmarrjet publike sipas shërbimeve dhe produkteve parësore që ofrojnë. Ndërmarrjet publike të cilat ofrojnë produkte dhe shërbime parësore financiare klasifikohen si ndërmarrje financiare publike. Ato klasifikohen si ndërmarrje financiare publike që pranojnë depozita (p.sh., banka qendrore, banka të nivelit të dytë, banka kursimi, banka krediti rurale/ bujqësore dhe banka eksport-importi) dhe ndërmarrje të tjera financiare publike (p.sh., fonde të tregut të parasë dhe fonde investimi jo të tregut të parasë) (GFSM 2014, paragrafët 2.115 deri 2.121).

45. Në dallim nga kjo, të gjitha ndërmarrjet e tjera publike (pra, ndërmarrjet që ofrojnë kryesisht mallra tregu ose shërbime jo financiare) klasifikohen si jofinanciare. Shembuj të ndërmarrjeve publike jofinanciare janë linjat ajrore kombëtare, shoqëritë kombëtare të energjisë elektrike dhe hekurudhat kombëtare, nëse këto shoqëri tregtare faturojnë çmime me rëndësi ekonomike (GFSM 2014, paragrafi 2.114).

46. Së katërti, është e nevojshme të klasifikohen njësitë e qeverisjes së përgjithshme sipas nivelit të qeverisjes të cilit i përkatësin, pra qeverisja në nivel qendror, nivel shteti dhe nivel lokal. Në disa vende, mund të ketë një nënsektor të katërt për fondet e sigurimeve shoqërore. Ky paraqitet kur qeveria nuk vendos ta përfshijë brenda kategorive të cilat përkojnë me nivelin e qeverisjes. Krahas kësaj, secili prej nënsektorëve të qeverisjes së përgjithshme mund të zërthehet më tej në buxhetor dhe jashtëbuxhetor. **Figura 5** sintetizon përvijimin e sektorit publik, sektorit të qeverisjes së përgjithshme dhe nënsektorëve të tyre sipas GFSM 2014

**Figura 5.** Përvijimi i sektorit publik, sektorit të qeverisjes së përgjithshme dhe nësektorëve të tyre sipas GFSM 2014



Legjenda:

- Kjo trajtë tregon njësi institucionale publike rezidente të territorit ekonomik A.
- △ Kjo trajtë tregon njësi institucionale publike jo rezidente të territorit ekonomik A.
- ⋮ Kjo trajtë tregon ndërmarrje publike që pranon depozita.
- ▣ Kjo trajtë tregon thuajse ndërmarrje.
- ⊠ Kjo trajtë tregon ndërmarrje publike financiare tjetër.
- ▨ Kjo trajtë tregon fonde të sigurimeve shoqërore (FSSH).
- ⌘ Ky simbol tregon bankën qendrore.
- Kjo ngjyrë tregon njësi buxhetore.
- Kjo ngjyrë tregon njësi jashtëbuxhetore.
- Kjo ngjyrë tregon ndërmarrje shtetërore (NSH) të kontrolluar drejtpërdrejt ose tërthorazi nga qeveria në nivel qendror, nivel shteti dhe/ose nivel vendor.
- - - Vija e ndërprerë tregon fonde të sigurimeve shoqërore kur janë të bashkuara në një nënsektor më vete pa integruar nënsektorët në nivel qendror, nivel shteti dhe/ose vendor, duke qenë se mund të jenë ose të klasifikuar si nënsektor më vete të sektorit të qeverisjes së përgjithshme, ose si pjesë e nënsektorit që i kontrollon.

Burimi: Ekipi i Bankë Botërore, mbështetur në GFSM 2014

## 2.4. Procesi i konsolidimit sipas SNKSP-ve

47. Procesi i konsolidimit sipas SNKSP-ve kërkon zbatimin e një renditjeje hapash që përfshijnë aspekte administrative dhe operative. Në këtë pjesë jepet një prezantim i përgjithshëm i procesit të konsolidimit sipas SNKSP-ve dhe aktiviteteve kryesore të tyre. Në funksion të krahasimit, procesi dhe aktivitetet e tij përshkruhen në **Figurën 6**, duke marrë si bazë diagramin e ilustruar në Udhëzuesin e Krahasimit për të paraqitur modelin e procesit të referimit për përpilimin e statistikave financiare të qeverisë, që prezantohet edhe në **Pjesën 2.5** të këtij dokumenti teknik.

### 2.4.1. Faza 1: Përgatitja fillestare, mirëmbajtja dhe puna përgatitore

#### 2.4.1.1. Hapi 1: Përvijimi i njësisë ekonomike me anë të parimit të kontrollit

48. Gjatë përvijimit të njësisë ekonomike, është e nevojshme të përcaktohet njësia kontrolluese dhe njësitë e kontrolluara të saj duke mbajtur në konsideratë kriteret për vlerësimin e kontrollit sipas SNKSP 35 të ilustruara në **Figurën 3** dhe të shpjeguara në **Pjesën 2.2**. Vlerësimi i kontrollit duhet bërë për të gjitha njësitë e sektorit publik, pavarësisht nëse ndodhen në territore të ndryshme ekonomike apo nëse janë apo jo krijuese tregu.

**Figura 6.** Procesi i konsolidimit sipas SNKSP-ve



Burimi: Ekipi i Bankës Botërore, mbështetur në SNKSP

### 2.4.1.2. Hapi 2: Përdorimi i një plani kontabël të unifikuar dhe harmonizuar për të raportuar informacionin

49. Për mbledhjen e të dhënave të njësive, duhet hartuar një plan kontabël i unifikuar dhe i harmonizuar për kontabilizimin dhe raportimin e të gjitha veprimeve dhe të ngjarjeve të tjera ekonomike nga të gjitha njësitë brenda objektit të konsolidimit. Struktura dhe nomenklatura e planit kontabël duhet të marrë në konsideratë spektrin e gjerë të funksioneve, aktiviteteve dhe operacioneve të çdo njësie si edhe kornizat e ndryshme rregullatore të kontabilitetit të përdorura për të identifikuar llogaritë që kanë nevojë për veprime rregulluese.

50. Në rastin ideal, plani kontabël duhet të ndjekë një strukturë dhe nomenklaturë e cila do të mund të shërbente për kornizat e referimit kontabël, buxhetor dhe statistikor të zbatueshme në vend. Përndryshe, duhet të ofrojë një kod i cili të mund të konvertohen ose transferohet lehtësisht në kodet e përdorura në statistikat financiare të qeverisë.

### 2.4.1.3. Hapi 3: Përdorimi i të njëjtave politikave kontabël

51. Përpara kryerjes së çdo aktiviteti dhe procedure konsolidimi, njësia kontrolluese e identifikuar në hapin e parë duhet të sigurojë që njësitë e kontrolluara prej saj të zbatojnë të njëjtat politika kontabël. Në një vend të vetëm, mund të ndodhë që të bashkekzistojnë disa korniza kontabël të zbatueshme për qeverinë dhe njësitë e tjera të sektorit publik, në varësi të madhësisë, natyrës, qëllimit, funksioneve ose aktiviteteve të tyre (p.sh., qeveria përdor SNKSP-të, ndërsa NSH-të përdorin Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) ose standardet kombëtare të kontabilitetit të sektorit privat). Kjo situatë bën që njësitë e përfshira në objektin e konsolidimit të kenë baza, parime dhe kritere të ndryshme kontabël për të përfshirë dhe paraqitur të njëjtat veprime ose ngjarje ekonomike në pasqyrat financiare individuale të tyre.

52. Për të përdorur të njëjtat politika kontabël në pasqyrat financiare të konsoliduara, njësia kontrolluese duhet të nxjerrë një paketë me udhëzime për të marrë informacionet me elementet e veçanta të nevojshme (p.sh., raporte financiare sipas SNKSP-ve,

kur politikat kontabël sipas SNRF-ve ose standardeve kombëtare të kontabilitetit të sektorit privat janë të ndryshme). Në disa vende, kjo paketë udhëzuese përfshin udhëzime, modele tip dhe urdhra konkrete për mbylljen e kontabilitetit për të shmangur konvertimin e vështirë të pasqyrave financiare të NSH-së nga njësia qeveritare përgjegjëse për hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara.

### 2.4.1.4. Hapi 4: Përdorimi i të njëjtës datë ndarëse të pasqyrave financiare

53. Në disa vende, data e mbylljes së pasqyrave financiare të njësive kontrolluese dhe njësive të kontrolluara përkon me ditën e fundit të vitit kalendarik ose buxhetor. Mirëpo, në raste të jashtëzakonshme, një anëtar i njësisë ekonomike mund t'i kërkohej (ose mund të vendosë) t'i hartojë pasqyrat financiare më një tjetër datë, për shembull për ta harmonizuar ciklin kontabël më pranë ciklit të shfrytëzimit, çka është në përputhje me SNKSP-të (SNKSP 1, paragrafët 66 deri 68).

54. Kur fundi i periudhës së pasqyrave financiare individuale të një anëtari të njësisë ekonomike është i ndryshëm nga ai i pasqyrave financiare të konsoliduara, njësia kontrolluese duhet të kërkojë, në funksion të konsolidimit, informacion shtesë në të njëjtën datë me pasqyrat financiare të konsoliduara. Si alternativë, ajo bën veprime rregulluese në procesin e konsolidimit, duke përdorur informacionin financiar më të fundit të raportuar nga anëtari i njësisë ekonomike për të përfshirë efektet e transaksioneve ose ngjarjeve të rëndësishme që ndodhin midis datës së atyre pasqyrave financiare dhe datës së pasqyrave financiare të konsoliduara (SNKSP 35, paragrafi 46).

### 2.4.1.5. Hapi 5: Zhvillimi dhe përditësimi i një sistemi ose algoritmi për konsolidimin

55. Procesi i konsolidimit kërkon një analizë të të dhënave të mbledhura nga njësitë në kuadër të konsolidimit për të identifikuar diferencat e mundshme që lindin si pasojë e zbatimit të kornizave dhe politikave të ndryshme kontabël. Në vendet ku nevojitet të konsolidohet një numër i madh njësisë

të cilat përdorin sisteme të ndryshme të integruara të informacionit të menaxhimit financiar, baza të ndryshme kontabël dhe praktika të ndryshme, do të ishte e vështirë të eliminoreshin transaksionet reciproke dhe të bëheshin veprime të tjera rregulluese të konsolidimit.

56. Një strategji e mundshme për ta lehtësuar këtë proces është zhvillimi i një sistemi ose algoritmi konsolidimi për të bërë përpunim automatik të të dhënave, siç është SIIMF. Në mënyrë ideale, sistemi ose algoritmi i zhvilluar do të duhej të merrte në konsideratë transaksionet reciproke dhe bashkimin e zërave të ngjashëm të aktiveve, detyrimeve, aktiveve neto, të ardhurave, shpenzimeve dhe flukseve monetare.

## 2.4.2. Faza 2: Konsolidimi i të dhënave financiare

### 2.4.2.1. Hapi 6: Mbledhja e të dhënave të njësive

57. Ka tri qasje që mund të përdoren për të mbledhur të dhënat e njësive: qasja e centralizuar, qasja e decentralizuar dhe qasja hibride. Përzgjedhja e qasjes varet nga organizimi institucional, kapacitetet, mjetet mbështetëse dhe shkalla e automatizimit. Pavarësisht nga qasja e përzgjedhur, duhet përdorur plani kontabël i unifikuar dhe i harmonizuar, që është zhvilluar në hapin e dytë dhe është përshkruar në **Pikën 2.4.1.2.**

58. Qasja e centralizuar kërkon që të gjitha njësitë e përfshira në objektin e konsolidimit t'i regjistrojnë transaksionet dhe ngjarjet e tjera ekonomike në të njëjtin sistem informatik dhe, për rrjedhojë, njësia kontrolluese mund t'i nxjerrë të dhënat drejtpërdrejt nga burimi për të përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara, ose raportet e konsoliduara mund të krijohen në mënyrë automatike. Mirëpo kjo qasje mund të mos jetë e realizueshme në shumë vende për shkak të kufizimeve ligjore, teknologjike dhe burimore.

59. Qasja e decentralizuar do të thotë që secila njësi e përfshirë në objektin e konsolidimit përdor sistemin e vet financiar dhe, për rrjedhojë, të dhënat për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara

i dorëzohen njësisë kontrolluese nga secila njësi e kontrolluar. Zbatimi i kësaj qasjeje sjell vështirësi të lidhura me kohën e mbledhjes së të dhënave, cilësinë e të dhënave financiare dhe kompleksitetin e procedurave të konsolidimit.

60. Në fund, qasja hibride kërkon që një pjesë e njësive të përfshira në objektin e konsolidimit, sidomos njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të përdorin të njëjtin sistem informatik, ndërsa një pjesë tjetër, përgjithësisht ndërmarrjet shtetërore, përdorin sistemin e vet dhe për rrjedhojë njësia kontrolluese ka të drejtë hyrjeje në shumicën e të dhënave. Me zbatimin e kësaj qasjeje, mund të marrin përgjigje shumica e vështirësive të procesit të konsolidimit.

### 2.4.2.2. Hapi 7: Verifikimi i përputhshmërisë së të dhënave të mbledhura

61. Pas mbledhjes së të dhënave të njësive, duhen kryer kontrole të cilësisë dhe pranueshmërisë së të dhënave (p.sh., kontrollohet përdorimi i saktë i llogarive, verifikimeve të vlerave, rakordimeve dhe transaksioneve reciproke) për të identifikuar ndonjë mospërputhje materiale. Nëse ka, duhet informuar njësia përkatëse, në mënyrë që të mund të bëjë rregullimet përkatëse në informacionet e saj financiare.

### 2.4.2.3. Hapi 8: Kryerja e rregullimeve të konsolidimit

62. Në këtë hap, duhen kryer këto rregullime të konsolidimit, në përputhje me SNKSP 35: i. kombinimi ose bashkimi i zërave të aktiveve, detyrimeve, aktiveve/kapitalit neto, të ardhurave, shpenzimeve dhe flukseve monetare të njësisë kontrolluese me ato të njësive të saj të kontrolluara; ii. kompensimi ose eliminimi i vlerës kontabël neto të investimit të njësisë kontrolluese në çdo njësi të kontrolluar me pjesën e aktiveve/kapitalit neto të njësisë kontrolluese të secilës njësi të kontrolluar; dhe iii. eliminimi i plotë i tepricave dhe transaksioneve financiare reciproke. Për të kryer rregullimet duhet përdorur sistemi ose algoritmi i konsolidimit i zhvilluar në hapin e pestë dhe i përshkruar në **Pikën 2.4.1.5.**



#### 2.4.2.4. Hapi 9: Verifikimi i rezultateve të përfuara

63. Pas konsolidimit të të dhënave, duhen kryer veprimet e kontrollit të cilësisë, siç është verifikimi për t'u siguruar që nuk ka transaksione ose teprica për t'u rakorduar, kontrollimi i përputhshmërisë së shumave të vlerave të konsoliduara dhe shqyrtimi i ndryshimeve në llogari. Për t'i kryer këto veprime duhet përdorur sistemi ose algoritmi i konsolidimit i zhvilluar në hapin e pestë dhe i përshkruar në **Pikën 2.4.1.5**.

### 2.4.3. Faza 3: Raportimi financiar

#### 2.4.3.1. Hapi 10: Nxjerrja e pasqyrës financiare të konsoliduar

64. Në këtë hap, përgatiten informacionet shpjeguese, tabelat e përgatitura në mënyrë manuale dhe informacionet e tjera shtesë që shoqërojnë pasqyrat financiare të konsoliduara. Duhet kryer veprime të kontrollit të cilësisë për të verifikuar pranueshmërinë e teksteve dhe tabelave të përgatitura në mënyrë manuale. Kur të jetë gati një version përfundimtar i pasqyrave financiare të konsoliduara, ky duhet të marrë miratimin e autoritetit përkatës dhe të publikohet.

## 2.5. Procesi i përpilimit sipas GFSM 2014

65. Si edhe në proceset e konsolidimit të përshkruara në **Pikën 2.4**, edhe procesi i përpilimit kërkon ndjekjen e një vargu hapash që përfshijnë aspekte administrative dhe operative, për krijimin e produkteve statistikore. Procesi i përpilimit është përshkruar në Udhëzuesin e krahasimit, siç paraqitet në **Figurën 7**, me disa rregullime. Gjithsesi, në këtë dokument teknik nuk është përfshirë shpjegimi i çdo hapi të procesit të konsolidimit. Lexuesi mund të gjejë shpjegimet e plota për këtë proces në faqet 29-31 të Udhëzuesit të krahasimit.


66. Procesi i përpilimit fillon me përvijimin e objektit institucional. Përvijimi i produkteve statistikore, sipas GFSM 2014 përdor klasifikimin sektorial të njësive publike. Kjo kërkon identifikimin e njësisë rezidente, për t'i dalluar nga njësitë që i përkasin pjesës tjetër të botës. Hapat e mëposhtëm përfshijnë identifikimin e njësive institucionale dhe verifikimin nëse njësitë institucionale janë të kontrolluara drejtpërdrejt ose tërthorazi nga qeveria.

67. Të gjitha njësitë institucionale të kontrolluara nga qeveria i përkasin sektorit publik. Siç përmendet në **Pikën 2.3**, sektori publik mund të ndahet në sektorin e qeverisjes së përgjithshme dhe sektorin e ndërmarrjeve publike. Sektori i qeverisjes së përgjithshme përfshin ato njësi institucionale që nuk janë krijuese të tregut, ndërsa sektori i ndërmarrjeve publike përfshin krijuesit e tregut. Po kështu, secili sektor mund të ndahet në nënsektorë, siç është thënë tashmë më lart.

68. Mirëpo, në praktikë, të dhënat nga njësitë institucionale mblidhen për të përbërë nënsektorë dhe sektorë dhe, më rëndom, për të përbërë sektorin e qeverisjes së përgjithshme dhe sektorin e ndërmarrjeve publike. Përvijimi i objektit të përpilimit në ngritjen fillestare, mirëmbajtjen dhe punën përgatitore nuk mbulon vetëm sektorin e qeverisjes së përgjithshme sipas GFSM 2014 – kjo është theksuar në hapin e parë të procesit të përpilimit të paraqitur në **Figurën 7**.

69. Hapat e propozuar në **Figurën 7** përbëjnë veprimet e nevojshme për të nxjerrë produktet statistikore me të dhënat e KSP-së. Këto të dhëna të KSP-së përshkruhen si pikënisje për procesin e përpilimit duke përdorur objektin e vendosur nga GFSM 2014. Gjatë përpilimit, lipsen regjistruar disa rregullime të rëndësishme metodike, sepse ka dallime në parimet e njohjes dhe matjes midis kuadrit kontabël dhe atij statistikor. Disa prej këtyre rregullimeve mund të ishin rregullimet për diferencat në: i. politikat kontabël; ii. datën e raportimit; iii. bazat e raportimit dhe iv. ndryshimet metodike (de Clerck, 2022).

Figura 7. Procesi i përpilimit sipas GFSM 2014



Burimi: Udhëzuesi i krahasimit, 2019



# 3

## PËRVOJAT NDËRKOMBËTARE

70. Në këtë krye paraqiten përvojat ndërkombëtare për konsolidimin dhe përpilimin e të dhënave nga katër vende: Brazili, Gjeorgjia, Spanja dhe Zvicra. Këto vende janë përzgjedhur në bazë të tri kriterëve: i. zbatimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i SNKSP-ve; ii. përdorimi i GFSM 2014 ose i Sistemit Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (ESA) 2010 për hartimin e statistikave financiare qeveritare; iii. të paktën njëri prej vendeve të përzgjedhura është përfutues i programit PULSAR (Gjeorgjia) dhe një tjetër (Brazili) bën pjesë në rrjetin "Forumi i Kontabilistëve Shtetërore të Amerikës Latine" (FOCAL).

71. Informacioni për praktikat është marrë nëpërmjet: i. pyetësorëve (shih **Shtojcën 1**); dhe ii. studimeve nga zyra. Pyetësi u përgatit nga autorët e këtij dokumenti teknik, për të marrë informacionet e nevojshme për arritjen e objektivin e dokumentit. Katër vendet morën të njëjtin pyetësor nga fundi i majit 2022. Përgjigjet i dhanë zyrtarët e sektorit publik përgjegjës për procesin e konsolidimit dhe përpilimit, përgjigje të cilat u dorëzuan nga fundi i qershorit 2022.

72. Studimet nga zyra konsistojnë në një shqyrtim dhe analizë të raporteve, manualeve dhe legjislacioneve të përmendura nga publiku në përgjigjet e tyre dhe të marra nga faqet zyrtare në internet të vendeve. Përvoja e çdo vendi paraqitet veçmas, në pjesët në vijim.

### 3.1. Brazili

#### 3.1.1. Konteksti

73. Emri zyrtar i Brazilit është Republika Federative e Brazilit. Përkufizohet me kushtetutë si një shtet ligjor demokratik, me sistem presidencial. Brazili është vend federal, organizimi politiko-administrativ i të cilit ka tri nivele të qeverisjes: nivel federal, shtetëror dhe vendor. Qeverisja në nivel federal përfshin Bashkimin, ndërsa qeverisjes në nivel shteti dhe nivel vendor përbëhen përkatësisht nga 26 shtete dhe 5.568 bashki, të gjitha autonome. Krahas kësaj, ka

një Distrikt Federal, që përfshihet në nivelin shtetëror të qeverisjes për qëllime kontabiliteti dhe statistike. Vendi ka ndjekur veçimin trepalësh të pushteteve: ekzekutivi, legjislativi dhe gjyqësori. Nga ana e tij, pushteti gjyqësor është i organizuar në nivel federal dhe nivel shtetëror dhe në Distriktin Federal.

### 3.1.2. Procesi i konsolidimit

74. Në nivel qendror, pasqyrat financiare të konsoliduara të federatës dhe sektorit publik i harton Sekretariati i Thesarit Kombëtar (STN, shkurtimi në portugalisht), duke ndjekur Standardet Braziliene të Kontabilitetit të Sektorit Publik, të publikuara nga Këshilli Brazilian Federal i Kontabilitetit (CFC, shkurtimi në portugalisht), të mbështetura në SNKSP. Pasqyrat financiare të konsoliduara të federatës mbulojnë Bashkimin, duke përfshirë të tre pushtetet dhe ndërmarrjet shtetëror jo krijuese të tregut.

75. Nga ana tjetër, pasqyrat financiare të konsoliduara të sektorit publik përfshijnë Bashkimin, Distriktin Federal dhe të gjitha shtetet dhe bashkitë dhe ndërmarrjet shtetërore të tyre jo krijuese të tregut, në përputhje me kërkesat ligjore. Ndërmarrjet shtetërore krijuese të tregut paraqiten në të dy paketat e pasqyrave financiare të konsoliduara sipas metodës së kapitalit neto. Nën nivelin qendror, Distrikti Federal, si edhe çdo shtet dhe bashki, është përgjegjës për konsolidimin e tij, duke respektuar të njëjtën kornizë rregullatore të kontabilitetit të zbatueshme në nivel qendror.

76. Të tre nivelet e qeverisjes përdorin planin kontabël kombëtar dhe sistemin e tyre të kontabilitetit për të bërë konsolidimin e vet. Në dallim nga kjo, konsolidimi i sektorit publik fillon me grupin e rregullave të vendosura nga STN-ja për marrjen e të dhënave financiare nga tre nivelet e qeverisjes. Bashkimi, Distrikti Federal dhe çdo shtet dhe bashki ia dërgojnë të dhënat e tyre, siç kërkohet me ligj, një sistemi të administruar nga STN-ja, që quhet "Sistemi Informatik Kontabël dhe Fiskal për Sektorin Publik Brazilian" (SICONFI, shkurtimi portugalisht).

77. Të dhënat dërgohen në dy formate digjitale të standardizuara: një raport kontabël, i krijuar për të lejuar konsolidimin e llogarive publike, dhe të dhëna të hollësishme për përdorimin e Matricës së Tepricave Kontabël, baza e së cilës është plani kontabël

kombëtar në formatin e bilancit vërtetues. Pas marrjes së informacionit, STN-ja ndan vlerat e transaksioneve të cilat do të përfshihen ose nuk do të përfshihen në procesin e konsolidimit, duke identifikuar transaksionet reciproke. Ky proces bëhet në nivelin V të planit kontabël kombëtar, që përdoret nga çdo njësi publike për të treguar nëse tepricat e llogarive duhen eliminuar në pasqyrat financiare të konsoliduara. Hapi tjetër është të shtohen informacionet në shënimet e pasqyrave financiare.

78. Vështirësia kryesore në procesin e konsolidimit në sektorin publik është larmia e sistemeve kontabël të përdorura nga njësitë publike, me strukturë dhe teknologji jo të standardizuara, dhe disa prej tyre u mungojnë kriteret minimale të sistemit. Për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi, është publikuar Vendimi nr. 10 540, datë 5.11.2020, me të cilin vendosen kërkesat minimale të cilësisë për sistemet e kontabilitetit dhe menaxhimit financiar. Këto rregulla synojnë të zvogëlojnë problemet e lindura nga keqpërdorimi i sistemeve, si regjistrimet kontabël prapavepruese dhe procedura të tjera të cilat bien ndesh me standardet e kontabilitetit. Krahas kësaj, janë ofruar formime dhe instruksione nga STN-ja dhe CFC-ja, për të ndihmuar në përmirësimin e informacionit kontabël.

### 3.1.3. Procesi i përpilimit

79. STN përpilon edhe statistikat financiare qeveritare të qeverisjes së përgjithshme, përfshirë të gjitha njësitë institucionale të kontrolluara nga njësitë e qeverisjes në nivel qendror, shteti dhe vendor, në përputhje me Manualin e Statistikave Buxhetore të Thesarit Kombëtar (TN, shkurtimi portugalisht) që mbështetet në GFSM 2014. Fondet e sigurimeve shoqërore paraqiten si pjesë e njërive institucionale buxhetore në çdo nivel të qeverisjes. Banka Qendrore e Brazilit nuk përfshihet në statistikat financiare qeveritare të qeverisjes së përgjithshme, sepse hyn te shoqëritë financiare publike, që klasifikohen si pjesë e sektorit publik si i tërë por nuk përfshihen në qeverisjen e përgjithshme. Nuk përpilohen dhe as publikohen statistika buxhetore të sektorit publik si i tërë.

80. Për të përpiluar statistikat financiare qeveritare të qeverisjes së përgjithshme, STN përdor të dhënat e marra nga SICONFI dhe nga Sistemi i Administrimit Financiar të Qeverisë Federale (SIAFI, shkurtimi në

portugalisht) dhe nga partneritetet me subjekte të tjera, si Instituti Brazilian për Ekonominë e Zbatuar dhe Studime (IPEA, shkurtimi në portugalisht) dhe Banka Qendrore e Brazilit. Pavarësisht nga kërkesa ligjore, më pak se 10% e bashkive nuk e zbatojnë procesin e dërgimit të të dhënave në SICONFI. Për këtë arsye, STN përdor teknika statistikore për të nxjerrë shifrat për të gjitha bashkitë.

81. Kjo metodikë përdor të dhëna edhe nga burime të tjera, si portalet e transparencës dhe platforma të tjera të qeverisë. Hapi tjetër në përpilim është konvertimi i klasifikimit buxhetor brazilian në kornizën GFSM 2014. Pasi nxirren statistikat e çdo nënsektori, bëhet një proces konsolidimi për të krijuar të dhënat e qeverisjes së përgjithshme. Për të bërë këtë, eliminohen transaksionet midis nënsektorëve dhe zgjidhet çdo mospërputhje midis të ardhurave dhe shpenzimeve totale ndërqeveritare. Përpilimi dhe versioni përfundimtar i pasqyrave bëhet në Microsoft Excel.

82. Vështirësitë kryesore të procesit të përpilimit janë:

1. Marrja dhe përpunim i një sasive të madhe të dhënash nga një numër i madh njësisish publike.
2. Gatishmëria dhe qarkullimi i vazhdueshëm i informacionit nga disa njësi institucionale të sektorit qendror jashtëbuxhetor, për shkak të mungesës së centralizimit të të dhënave.
3. Gatishmëria e informacionit kontabël dhe buxhetor të një numri të vogël njësisish institucionale të qeverisjes vendore për shkak të mosdërgimit të të dhënave në zbatim të kërkesave dhe afateve ligjore.
4. Sigurimi i përputhshmërisë së informacionit që japin njësi të ndryshme institucionale, kryesisht ato të qeverisjes vendore.
5. Ndryshueshmëria në interpretimin e rregullave kontabël mes njërive të qeverisjes në nivel shteti dhe në nivel vendor.
6. Sigurimi i cilësisë së të dhënave që japin shumë njësi institucionale të qeverisjes vendore për shkak të personelit dhe kapacitetit administrativ të pakët.
7. Mospërputhje mes shumëve të regjistruara nga sektorët për transaksionet midis nënsektorëve të qeverisjes së përgjithshme, si grantet që qeverisja qendrore ua jep shteteve dhe njërive të qeverisjes vendore.

83. Për t'u dhënë zgjidhje vështirësive të përpilimit, është zhvilluar Matrica e Bilanceve Kontabël, që e ka rritur ndjeshëm gatishmërinë e të dhënave për qeverisjen në nivelin qendror. Ajo përbëhet nga një vëllim i madh të dhënash të nxjerra drejtpërdrejt nga sistemet kontabël dhe financiare dhe që i dërgohen çdo muaj sistemit SICONFI. Është tashmë një prej burimeve kryesore të të dhënave për shtetet dhe shpejt do të zbatohet edhe për bashkitë. Zbatimi i saj ka kërkuar formim të gjerësishëm dhe cilësia e të dhënave është përmirësuar ndjeshëm pas futjes në zbatim.

84. Sa u takon të dhënave që mungojnë nga njësitë e qeverisjes vendore, një partneritet midis TN-së dhe IPEA-s solli si rezultat zhvillimin e teknikës së nxjerrjes statistikore, që është aktualisht në zbatim. Së fundi, për t'u dhënë zgjidhje mospërputhjeve të shumëve të regjistruara nga sektorët, pati një përditësim të metodikës për të minimizuar ndikimin e procesit të konsolidimit në llogaritë e tjera.

## 3.2. Gjeorgjia

### 3.2.1. Konteksti

85. Gjeorgjia zyrtarisht quhet Gjeorgjia, sipas kushtetutës së vendit. Është republikë unitare ku pushtetin e ushtron qeverisja qendrore. Gjeorgjia ka demokraci me përfaqësim, ku qytetarët e ushtrorë pushtetin nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur. Pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2018, vendi do ta lërë sistemin gjysmëpresidencial të qeverisjes dhe do të bëhet sistem plotësisht parlamentar në vitin 2024. Organizimi politik dhe administrativ përfshin dy nivele të qeverisjes: qendror dhe vendor.

86. Qeverisja qendrore përfshin organet e shtetit, përfshirë nëntë qarqe të cilat nuk janë njësi të vetëqeverisjes. Sipas të dhënave të Agjencisë Kombëtare të Regjistrimit Publik (AKRB), qeverisja vendore konsiston në dy republika autonome (Abhazia dhe Axhara) dhe 69 bashki, prej të cilave 64 janë bashkësi me vetëqeverisje dhe 5 janë qytete me vetëqeverisje, përfshirë Tbilisin, i cili ka status juridik të veçantë si kryeqytet i vendit.

### 3.2.2. Procesi i konsolidimit

87. Në nivel qendror, procesi i konsolidimit kryhet nga Shërbimi i Thesarit të Shtetit pranë Ministrisë së Financave (Shërbimi i Thesarit), në bazë të SNKSP-ve, që janë zbatuar drejtpërdrejt nëpërmjet rregullave kombëtare. Konsolidimi përfshin të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore në bazë të rregullimeve buxhetore: organizatat buxhetore, subjektet juridike të së drejtës publike (SJD) dhe subjektet juridike jotregtare (SJJT). NSH-të krijuese të tregut nuk përfshihen në konsolidim. Poshtë nivelit qendror, konsolidimi kryhet nga republikat autonome dhe bashkitë duke përdorur të njëjtin kuadër kontabël; konsolidimi përfshin, sipas kriterëve buxhetore, SJD-të dhe SJJT-të e tyre të kontrolluara.

88. Procesi i konsolidimit fillon kur njësitë shpenzuese buxhetore qendrore, republikat autonome dhe bashkitë hartojnë pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara në bazë të pasqyrave/raporteve financiare të veçanta të dorëzuara nga njësitë e kontrolluara prej tyre. Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të depozitohen pranë Thesarit të Shtetit jo më vonë se data 1 prill të vitit pasardhës.

89. Në bazë të këtyre të dhënave, Thesarit i Shtetit harton pasqyrat financiare të konsoliduara të buxhetit qendror, që publikohen në faqen në internet të Shërbimit të Thesarit me pasqyrat financiare të konsoliduara të republikave autonome dhe bashkive në formë shtojce, jo më vonë se data 1 korrik. Procesi i konsolidimit në nivelin e buxhetit qendror bëhet në mënyrë manuale, duke përdorur tabela në Microsoft Excel, ndërsa disa njësi të qeverisjes vendore përdorin për këtë qëllim disa softuerë kontabiliteti.

90. Vështirësitë kryesore të identifikuar nga Shërbimi i Thesarit lidhur me procesin e konsolidimit janë: i. zhvillimi i paplotë i Librit të Madh të Thesarit në kuadër të sistemit elektronik të thesarit, që është aktualisht në fazë zhvillimi (kjo nuk lejon reflektimin automatik të të gjitha ngjarjeve ekonomike në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara); dhe ii. procedurat e ndërlikuara të konsolidimit për shkak të mungesës së një sistemit të automatizuar për konsolidimin e të dhënave financiare.

91. Aktualisht, nuk bëhet siç duhet, siç e kërkojnë SNKSP-të, agregimi i të dhënave financiare dhe bërja

e të gjithave veprimeve të nevojshme rregulluese në funksion të konsolidimit, siç është eliminimi i të gjitha tepricave të brendshme dhe transaksioneve midis subjekteve buxhetore; dhe iii. përdorimi i programeve të ndryshme kompjuterike për mbajtjen e llogarive në disa organizata, për qëllime kontabiliteti dhe raportimi.

92. Për t'u dhënë zgjidhje këtyre vështirësive, janë marrë këto masa:

1. Zhvillimi i manualeve të kontabilitetit dhe raportimit të mbështetur në SNKSP, që i publikon Shërbimi i Thesarit dhe që zbatohen njësoj nga njësitë e buxhetit qendror dhe njësitë e buxhetit vendor.
2. Seminare dhe formime organizohen rregullisht nga Shërbimi i Thesarit për kontabilistë të sektorit publik në nivel të buxhetit qendror si edhe të buxhetit vendor, për të mbështetur procesin e vënies në zbatim të SNKSP-ve.
3. Zhvillimi i politikave të brendshme të kontabilitetit nga njësitë shpenzuese mbështetur në veçantitë e SNKSP-ve, që janë në përputhje me metodikën e unifikuar dhe sigurojnë përputhshmërinë me SNKSP-në në nivel të çdo institucioni shpenzues.

### 3.2.3. Procesi i përpilimit

93. Përpilimi dhe shpërndarja e statistikave financiare qeveritare të qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjësi e Drejtorisë së Analizues Makroekonomike dhe Planifikimit të Politikave Buxhetore (DAMPPB) të Ministrisë së Financave, që përdor si kuadër statistikor GFSM 2001/2014. Të dhënat vjetore të statistikave financiare qeveritare mbulojnë qeverisjen e përgjithshme, pra njësitë buxhetore dhe ato jashtëbuxhetore të pushtetit qendror dhe vendor. Të dhënat me frekuencë të lartë mbulojnë vetëm nënsektorët buxhetorë në këto nivele të qeverisjes.

94. Në Gjeorgji nuk ka fond të sigurimeve shoqërore, por ndihma sociale jepet nga pushteti qendror, prandaj përfshihet në këtë nënsektor. Banka Kombëtare e Gjeorgjisë nuk përfshihet në statistikat financiare qeveritare të qeverisjes së përgjithshme, sepse hyn te shoqëritë financiare publike, që klasifikohen si pjesë e sektorit publik si i tërë por

nuk përfshihen në qeverisjen e përgjithshme. Nuk përpilohen dhe as publikohen statistika buxhetore të sektorit publik si i tërë në Gjeorgji.

95. Procesi i përpilimit fillon me mbledhjen e të dhënave për të gjitha transaksionet monetare nga organizatat buxhetore, që mbulojnë thuajse të gjitha njësitë buxhetore dhe jashtëbuxhetore të qeverisë së përgjithshme në nivel qendror dhe nivel vendor. Të dhënat burimore vijnë nga Shërbimi i Thesarit, që shërben si një thesar i centralizuar për njësitë shtetërore. Shërbimi i Thesarit ka një bazë të dhënash ku regjistrohen transaksionet e tij monetare. Të dhënat monetare të thesarit klasifikohen sipas klasifikimit të brendshëm/kombëtar, që mbështetet në GFSM 2001/2014 por është më i hollësishëm se klasifikimi fillestar GFSM.

96. Për hartimin e të dhënave buxhetore vjetore, si burim plotësues i të dhënave përdoret raporti financiar i mbështetur në SNKSP. Burime të tjera të dhënash janë raporte nga drejtoritë e përfshira në administrimin e borxhit ose të aktiveve, që përfshijnë informacion të vyer për konsolidimin e transaksioneve, sidomos ato që përfshihen në aktivet dhe detyrimet financiare. Përpilimi i të dhënave bëhet me dy hapa: së pari, një konsolidim brenda sektorit, dhe pastaj një konsolidim midis sektorëve, në bazë të rregullave të vendosura në kornizat statistikore të referimit. Procesi i përpilimit bëhet në mënyrë manuale, në Microsoft Excel.

97. Vështirësia kryesore për procesin e statistikave financiare qeveritare të qeverisjes së përgjithshme të paraqitura nga DAMPPB-ja si përdoruese e të dhënave të Shërbimit të Thesarit ka të bëjë me problemet e konvergencës midis SNKSP-ve dhe GFSM 2014, duke qenë se ndjekin objektiva dhe metoda të ndryshme. Në disa raste, të dhënat e SNKSP-ve mund të jenë aq të hollësishme sa ç'i kërkon GFSM 2014. Këto probleme të konvergencës mund të shkaktojnë probleme për përpiluesit e statistikave financiare qeveritare. Për t'i dhënë zgjidhje kësaj vështirësie, plani kontabël është duke u zhvilluar vazhdimisht, dhe ndërkohë standardet dhe rregullat e reja të kontabilitetit janë duke u futur aktivisht në zbatim gjatë dy viteve të fundit. Sa i takon të ardhmes, nëse rritet më tej mbulimi me llogarinë unike të thesarit, DAMPPB-ja mund të përmirësojë edhe mbulimin me statistika financiare qeveritare.

## 3.3. Spain

### 3.3.1. Konteksti

98. Emri zyrtar i Spanjës është Mbretëria e Spanjës. Kushtetuta e përcakton vendin si një shtet shoqëror dhe demokratik, me monarki parlamentare si formë politike. Spanja është shtet unitar i decentralizuar, që përbëhet nga qeverisja në nivel qendror, rajonal dhe vendor, dhe institucionet e sigurimeve shoqërore. Qeverisja qendrore përbëhet nga Administrata e Përgjithshme e Shtetit (AGE, shkurtimi spanjisht). Qeverisja rajonale përfshijnë 17 bashkësi autonome dhe 2 qytete autonome (Ceuta dhe Melilla).

99. Qeverisja vendore përbëhet nga 8129 bashki dhe 50 provinca. Çdo qeveri autonome ka statutin e autonomisë dhe gëzon vetëqeverisje për administrimin e interesave përkatëse. Vetëqeverisja është e zbatueshme dhe për njësitë e qeverisjes vendore. Vendi ka ndjekur veçimin trepalësh të pushteteve: ekzekutivi, legjislativi dhe gjyqësori.

### 3.3.2. Procesi i konsolidimit

100. Në nivel qendror, Kontrollori i Përgjithshëm i Administratës Shtetërore (IGAE, shkurtimi në spanjisht) harton paketën e pasqyrave financiare të konsoliduara në bazë të planit të përgjithshëm kontabël publik (PGCP, shkurtimi në spanjisht), që është i harmonizuar me SNKSP-të, paçka se me disa dallime. Objekti i konsolidimit përcaktohet në përputhje me parimin e kontrollit të SNKSP 35 dhe përfshin AGE-në (njësinë kontrolluese), njësitë administrative dhe të sigurimeve shoqërore, institucionet jofitimprurëse dhe NSH krijuese dhe jo krijuese të tregut. Poshtë nivelit qendror, rajonet kanë ndër mend të hartojnë pasqyra financiare të konsoliduara. Njësitë e qeverisjes vendore me popullsi më të madhe se 50 mijë banorë do të kenë pasqyra financiare të konsoliduara në 2022, sipas të njëjtit standard me nivelin qendror.

101. Procesi hap pas hapi për hartimin e paketës së pasqyrave financiare të konsoliduara fillon me homogjenizimin e pasqyrave financiare të filialeve, nëse përdorin parime kontabiliteti të ndryshme



nga ato që përdor qeverisja qendrore. Ky proces mbulon edhe rastet e pasqyrave që nuk mbyllen më datë 31 dhjetor dhe vendos theksin te përputhja e transaksioneve të brendshme midis njësive që janë objekt i konsolidimit (data e raportimit, vlerat e ndryshme të regjistruara nga njësiti e përfshira në transaksionet mes palëve të lidhura). Procesi vijon me bashkimin e pasqyrave financiare të njësive mëmë dhe njësive bija, veprimet rregulluese të konsolidimit, dhe përfundon me publikimin e pasqyrave financiare të konsoliduara. Procesi i konsolidimit bëhet me mjete të ndryshme të automatizuara.

102. Vështirësitë kryesore të procesit të konsolidimit janë:

1. Trajtimi i një vëllimi të madh njësish dhe operacionesh.
2. Gatishmëria e të dhënave në datën e mbylljes së pasqyrave.
3. Gatishmëria e disa raporteve të auditimit pas konsolidimit. Ka raste kur audituesi mund të ketë zbuluar keqparaqitje të cilat kanë çuar në ndryshime të llogarive të veçanta të përfshira në llogaritë e konsoliduara.
4. Përdorimi i rregullave të ndryshme kontabël nga njësiti publike, shoqëritë tregtare, njësiti jofitimprurëse, institucionet e kreditit dhe njësiti e sigurimeve.
5. Kohë e kufizuar për të përpunuar informacionin dhe për të përgatitur pasqyra financiare të konsoliduara.

103. Për t'i zgjidhur këto vështirësi, janë zbatuar masat e mëposhtme:

1. Vendosja e një afati për marrjen e pasqyrave financiare të njësive që do të përfshihen në pasqyrat e konsoliduara të qeverisjes qendrore.
2. Përdorimi i një procesi elektronik për nxjerrjen e pasqyrave dhe dhënia e informacioneve shtesë për konsolidimin e operacioneve.
3. Standardizimi i rregullave kontabël të zbatueshme për njësiti e ndryshme.
4. Dhënia e udhëzimeve dhe urdhrave njësive për të dhënë informacion për konsolidimin dhe rakordimin e veprimeve kontabël.

### 3.3.3. Procesi i përpilimit

104. Statistikat financiare qeveritare të qeverisjes së përgjithshme i harton IGAE në bazë të Sistemit Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (ESA) 2010, të publikuara nga Zyra Statistikore e Bashkimit Evropian (Eurostat). Megjithëse kjo kornizë mbulon statistikën që përfshijnë sektorë të tjerë institucionalë, termi statistika financiare qeveritare sipas ESA 2010 mbulon vetëm sektorin e qeverisjes së përgjithshme dhe nënsektorët e tij, ose çdo grupim njësish qeveritare, si edhe njësi institucionale të veçanta, si qeverisja qendrore buxhetore (ESA 2010, paragrafi 20.75).

105. Statistikat financiare qeveritare sipas GFSM 2014, krahas përfshirjes së sektorit të qeverisjes së përgjithshme, mbulojnë edhe përpilimin e të dhënave për sektorin publik si të tërë, për të kapur veprimtaritë e tregut dhe operacionet thuajse buxhetore të ndërmarrjeve publike (GFSM 2014, paragrafi 2.4). Mirëpo, statistikën financiare qeveritare në Spanjë përfshijnë vetëm sektorin e qeverisjes së përgjithshme dhe nënsektorët e tij, pra qeverisjen qendrore, rajonale dhe vendore, si edhe fondet e sigurimeve shoqërore.

106. Procesi i përpilimit fillon me mbledhjen e të dhënave. IGAE përdor informacionet e marra nga pyetësorë të standardizuar të informacionit kontabël, të cilat i dërgojnë njësiti e administratës qendrore, bashkësitë autonome, pushteti vendor dhe fondet e sigurimeve shoqërore. Për këtë proces, përdoren mjete të automatizuara. IGAE hyn drejtpërdrejt edhe në kontabilitetin e njësive kryesore të shtetit dhe të organeve autonome në varësi të saj.

107. Pas procesit të mbledhjes, bëhen veprime rregulluese në burimet e të dhënave për të qenë në përputhje me ESA 2010 dhe me rregullat e vlerësimit të Procedurës së Deficitit të Tejkuluar (PDT). Në disa raste, duhet bërë një renditje e burimeve gjatë përpilimit të statistikave dhe përparësi u jepet burimeve parësore (të drejtpërdrejta). Pastaj, burimet e të dhënave u nënshtrohen teknikave të përpilimit, pas së cilës vjen publikimi i të dhënave. Për kryerjen e këtij procesi përdoren disa aplikacione të veçanta dhe Microsoft Excel.

108. Vështirësitë kryesore të procesit të përpilimit janë:

1. Marrja e të gjithë informacionit të nevojshëm në kohën e duhur.
2. Analizimi i të gjithë informacionit të marrë dhe identifikimi i trajtimit të saktë në kontabilitetin kombëtar.
3. Rakordimi dhe eliminimi i transaksioneve të brendshme midis sektorëve.

109. Për t'i zgjidhur vështirësitë e përpilimit, masat e marra janë ndërtimi i aplikacioneve të duhura dhe i pyetësorëve për marrjen e informacionit të standardizuar dhe telematik. Krahas kësaj, është ndjekur procesi i mësimit të metodikës kombëtare të kontabilitetit për trajtim të saktë të të dhënave dhe i bashkimit të personelit të specializuar dhe të kualifikuar për këtë.

## 3.4. Zvicra

### 3.4.1. Konteksti

110. Emërtimi zyrtar i Zvicrës është Konfederata Zvicerane. Zvicra është shtet federal me demokraci të drejtpërdrejtë. Kjo do të thotë se janë qytetarët ata që vendosin për nisma të caktuara politike, përmes votës popullore. Sistemi i qeverisjes është direktorial, me një organ kolegjal si autoriteti më i lartë dhe/ose shef i qeverisë në çdo nivel të qeverisjes: federal, kantonal dhe komunal. Qeverisja në nivel federal përfshin Konfederatën, ndërsa qeverisjet në nivel kantoni dhe nivel komunal përbëhen përkatësisht nga 26 shtete sovraane dhe 2142 komuna, të gjitha autonome. Vendi ka ndjekur veçimin trepalësh të pushteteve: ekzekutivi, legjislativi dhe gjyqësori.

### 3.4.2. Procesi i konsolidimit

111. Në nivel federal, Departamenti Federal i Financave (EFD, shkurtimi në gjermanisht), nëpërmjet Administratës Federale të Financave (EFV, shkurtimi në gjermanisht), kryen procesin e konsolidimit duke përdorur SNKSP-të, në përputhje me Modelin e Ri të Kontabilitetit të Konfederatës (NRM, shkurtimi në gjermanisht), të miratuar nga Këshilli Federal,

që është autoriteti më i lartë qeverisës ekzekutiv i Konfederatës.

112. Konsolidimi përfshin Konfederatën, përfshirë tri pushtetet, dhe pasqyrat e saj të posaçme, njësitë e decentralizuara administrative, NSH-të krijuese dhe jo krijuese të tregut dhe institucionet e sigurimeve shoqërore. Objekti përcaktohet në përputhje me parimin e kontrollit të SNKSP 35. Poshtë nivelit qendror, konsolidimi nuk është i detyrueshëm. Kantonet dhe komunat mund të bëjnë vullnetarisht konsolidimin e tyre, në bazë të rekomandimeve të dhëna në versionin e dytë të Modelit të Harmonizuar të Kontabilitetit për Kantonet dhe Komunat (HRM2, shkurtimi në gjermanisht), të miratuar nga Konferenca e Drejtorëve të Financave Kantonale, që është përgatitur duke iu referuar SNKSP-ve.

113. Procesi i konsolidimit në nivel federal fillon kur njësitë e konsolidimit (NJK) të cilat kontrollohen nga Konfederata hyjnë në të dhënat ndëroorganizative (NO) në Planifikimin dhe Konsolidimin e Punës të SAP-së (SAP BPC) jo më vonë se mesi i muajit shkurt, pas mbylljes së vitit ushtrimor. Më pas, të dhënat ndëroorganizative regjistrohen, ndërsa NJK-të hedhin disa të dhëna që kanë mbetur. Pasi rakordohen të dhënat, pasqyrat financiare të veçanta të NK-ve kontrollohen për efekt të përputhshmërisë dhe përcaktohen zërat e konsolidimit.

114. Deri në fund të shkurtit, kontrollohet përputhshmëria e vlerave të konsoliduara dhe hartohen tabelat manuale për të plotësuar informacionet financiare të paraqitura në pasqyrat financiare të konsoliduara. Paskëtaj, e deri në gjysmën e parë të marsit, në sistemin editorial shkruhen të gjitha tekstet dhe komentet mbi informacionet financiare dhe verifikohen të gjitha tabelat, listat dhe ndryshimet.

115. Në gjysmën e dytë të marsit, kryhen detyrat administrative dhe mekanizmat e kontrollit, të tilla si faqosja e pasqyrave financiare të konsoliduara dhe shqyrtimi dhe komente nga drejtori i EFD-së. Në fund të marsit dhe me të qenë gati versioni përfundimtar i pasqyrave financiare të konsoliduara, këto i dorëzohen Sekretarit të Përgjithshëm të EFD-së, i cili ia përcjell Ministrit të Financave. Me të marrë miratimin e ministrit, i dërgohen për miratim Këshilli Federal në fillim të prillit. Pas miratimit nga Këshilli Federal, publikohen në gjuhët gjermane, franceze, italiane dhe angleze. Kjo bëhet zakonisht në mes të prillit.

116. Vështirësitë kryesore të prezantuara nga EFV-ja lidhur me procesin e konsolidimit janë:

1. Përdorimi i parimeve dhe standardeve të ndryshme kontabël në NJK-të e veçanta për hartimin e raportimit financiar, p.sh., SNRF, SNKSP, HRM2 dhe të tjera rregulla të veçanta.
2. Afati i shkurtër për dorëzimin e të dhënave. Ka mundësi që disa NJK të cilat zbatojnë SNRF të dorëzojnë pasqyra financiare përfundimtare ende jo të audituara. Për rrjedhojë, mund të ndodhin ndryshime të cilat të kenë nevojë për korrigjime në pasqyrat financiare të konsoliduara.
3. Procesi i rakordimit të të dhënave shpërndahet në kohë dhe kërkon afërsisht dy ditë të realizohet.

117. Për t'u dhënë zgjidhje këtyre vështirësive, janë marrë këto masa:

1. Përdorimi i një analize të boshllëqeve për ato NJK që përdorin korniza të ndryshme kontabël, në mënyrë që të përcaktohet se cilët zëra të pasqyrës së bilancit dhe të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve duhen rregulluar sipas kërkesave të SNKSP-ve dhe deri në çfarë shkalle.
2. Përqendrimi te ato NJK vlerat e të cilave janë materiale për pasqyrat financiare të konsoliduara.
3. Përgatitja dhe miratimi i një plani kontabël të unifikuar dhe i një manuali konsolidimi nga EFV-ja. Ky manual rregullon me hollësi trajtimin e marrëdhënieve ndër-institucionale, trajton tema të veçanta, p.sh., kufijtë e materialitetit, vlerësimi i infrastrukturës, kreditë me kusht shlyerjeje, përfitimet e punëmarrësve etj. dhe jep udhëzime mbi tabelat e lëvizjeve dhe llojet e lëvizjeve.
4. Përgatitja e udhëzimeve të mbylljes për çdo pasqyrë financiare vjetore.
5. Zhvillimi i diskutimeve të mbylljes me NJK të cilat raportojnë sipas SNRF-ve, përpara fillimit të procesit të konsolidimit.
6. Caktimi i një mbikëqyrësi personal në çdo NJK, që është përgjegjës për të gjitha problemet e kontabilitetit dhe vlerësimit dhe çështjet teknike.
7. Formimi i përdoruesve të rinj të NJK-ve lidhur me veçantitë e konsolidimit dhe hyrjes së personalizuar në softuerin e konsolidimit.

### 3.4.3. Procesi i përpilimit

118. EFD, nëpërmjet EFV-së, është përgjegjëse për kryerjen e procesit të përpilimit të statistikave financiare qeveritare të qeverisjes së përgjithshme. Statistikat paraqiten duke përdorur dy modele: Modeli i Statistikave Financiare (Modeli SF) dhe Modeli i Statistikave Financiare Qeveritare (Modeli SFQ). Modeli SF realizohet në përputhje me modelin e kontabilitetit HRM2 dhe disa elemente të NRM-së.

119. Ky model paraqet statistikën e sektorit të qeverisjes së përgjithshme dhe të nënsektorëve të tij ekonomikë: konfederata, kantonet, komunat dhe fondet e sigurimeve shoqërore. Ai siguron statistika edhe në nivel të buxheteve individuale: qytete dhe kryeqytete të kantoneve, kantone dhe fondet individuale të sigurimeve. Nga ana e tij, Modeli SFQ ndjek GFSM 2014 dhe përdor si pikënisje Modelin SF. Në dallim nga Modeli SF, ky paraqet vetëm statistikën e sektorit të qeverisjes së përgjithshme dhe të nënsektorëve të tij më vete.

120. Banka Kombëtare Zvicerane nuk përfshihet as në Modelin SF, as në Modelin SFQ, sepse hyn te shoqëritë financiare publike, që klasifikohen si pjesë e sektorit publik si i tërë por nuk përfshihen në qeverisjen e përgjithshme. Nuk përpilohen dhe as publikohen statistika buxhetore të sektorit publik si i tërë, por është në plan të publikohen në të ardhmen. EFV përpilon edhe të dhënat bazë të sektorit të qeverisjes së përgjithshme për sistemin e llogarive kombëtare dhe ia dërgon Zyrës Statistikore Federale duke përdorur Modelin ESA që mbështetet në ESA 2010 dhe përgatitet nga Modeli SFQ.

121. Procesi i përpilimit të statistikave financiare qeveritare të qeverisjes së përgjithshme fillon me mbledhjen e të dhënave të njësive të cilat bëjnë pjesë në sektorin e qeverisjes së përgjithshme dhe nënsektorëve ekonomikë të tij. Mbledhja e këtyre të dhënave bëhet më së shumti përmes skedarëve elektronikë të standardizuar. Mirëpo, një pjesë e vogël e të dhënave dorëzohet në mënyrë jo të strukturuar dhe jo elektronike dhe duhen hedhur në sistem në mënyrë manuale. Skedarët elektronikë kontrollohen nga ana strukturore përpara se të importohen në sistem. Nëse dalin probleme, këto i raportohen njësive përkatëse.



122. Pastaj, të dhënat transformohen automatikisht në Modelin SF nëpërmjet tabelave kalimtare. Gjatë procesit, bëhet sektorizimi dhe disa njësi konsolidohen brenda njësive të qeverisjes së përgjithshme ose nxirren prej tyre. Krahas kësaj, kryhen kontrollet e cilësisë dhe pranueshmërisë së të dhënave, siç është krahasimi midis bilancit të të dhënave dhe pasqyrave financiare të çdo njësie, kontrolli i klasifikimeve për të siguruar që nuk ka mospërputhshmëri ose modifikime në lidhje me vitin e mëparshëm financiar dhe zberthimin e zërave. Pastaj, bëhet përpilimi brenda dhe ndërmjet nënsektorëve.

123. Me të dalë Modeli SF, të dhënat e tij transformohen në Modelin SFQ nëpërmjet tabelave kalimtare. Të dhënat përpunohen në mënyrë statistikore sipas këtyre hapave: i. vlerësimi me vlerën e tregut, ii. integrimi me llogaritë kombëtare, iii. rakordimi i të dhënave horizontale (që do të thotë se tepricat financiare në fillim të periudhës ushtrimore plus veprimet, rivlerësimet dhe ndryshimet e tjera të vëllimit të aktiveve dhe detyrimeve gjatë së njëjtës periudhë duhet të jenë të barabarta me tepricat në fund të periudhës ushtrimore) dhe iv. zberthimi i zërave në komponentë të brendshëm dhe të jashtëm.

124. Gjatë këtij procesi, bëhet sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë, për shembull kontrollohet bëhen nga Zyra Statistikore Federale (BFS, shkurtimi në gjermanisht) e Zvicrës ose Eurostati. Në bazë të rezultetit të kësaj, hartohet versioni përfundimtar i modelit SFQ, që është pikënisja për nxjerrjen e Modelit ESA. Modelet SFQ dhe ESA përgatiten duke përdorur gjuhën statistikore "R", ndërsa Modeli SF kryhet duke përdorur një ndërthurje të një instrumenti informatik të zhvilluar enkas për statistikën financiare para 10 vjetësh dhe një instrument të mbështetur në Microsoft Excel.

125. Vështirësitë kryesore që lindin në procesin e përpilimit të identifikuar nga EFV-ja janë:

1. Përdorimi i një kuadri kontabiliteti nga qeverisja e përgjithshme që ndryshon nga HRM2.
2. Mbeten shumë dallime midis praktikave kontabël të kantoneve dhe komunave, pavarësisht nga zbatimi i HRM2, për shkak të autonomisë së fortë të këtyre niveleve të qeverisjes.
3. Komunat nuk janë mbuluar plotësisht ende.
4. Vonësia në finalizimin e përpilimit për shkak se disa të dhëna nuk merren nga komunat në kohën e duhur.

126. Këto vështirësi kanë marrë zgjidhje nëpërmjet këtyre masave:

1. Përdorimi në të ardhmen e afërt nga i gjithë sektori i qeverisjes së përgjithshme të një plani kontabël i cili është i harmonizuar më mirë me HARM2.
2. Angazhime nga kantonet dhe komunat për të harmonizuar më tej të dhënat e tyre kontabël përmes një procesi të vazhdueshëm.
3. Miratimi i objektivit të arritjes së mbulimit të plotë të komunave brenda dy vjetëve.

## 3.5. Mësimet e nxjerra dhe praktikrat e mira

127. Katër vendet e analizuar në këtë dokument teknik janë të përkufizuara me kushtetutë si shtete demokratike. Tre prej tyre kanë demokraci përfaqësuese (Brazili, Gjeorgjia dhe Spanja), ndërsa njëri ka demokraci të drejtpërdrejtë (Zvicra). Mirëpo, të katër vendet kanë lloje të ndryshme sistemesh qeverisjeje. Nga sistemet presidenciale (Brazili) te monarkitë parlamentare (Spanja), sistemet gjysmëpresidenciale (Gjeorgjia) dhe sistemet me vendimmarrje të drejtpërdrejtë (Zvicra).

128. Po kështu, të gjitha vendet e analizuar kanë forma të ndryshme organizimi shtetëror dhe territorial. Dy prej tyre janë vende unitare (Gjeorgjia dhe Spanja), në të cilat pushteti ushtrohet kryesisht nga qeverisja qendrore. Dy të tjerët janë vende federale (Brazili dhe Zvicra), ku qeverisja rajonale dhe vendore kanë një shkallë të madhe autonomie. Tre prej katër vendeve të analizuar kanë tre nivele të qeverisjes (Brazili, Spanja dhe Zvicra) dhe njëri ka dy nivele të qeverisjes (Gjeorgjia). Numri i njësive poshtë nivelit qendror ndryshon gjithashtu ndjeshëm nga 70 (Gjeorgjia) në 8100 bashki (Spanja).

129. Sa u takon pasqyrave financiare të konsoliduara, katër vendet e analizuar paraqesin qasje të ndryshme sa i takon përcaktimit të objektit të konsolidimit. Megjithëse të gjitha syresh zbatojnë standarde kontabiliteti të mbështetur në SNKSP, qasja e kontrollit e përcaktuar nga SNKSP 35 përdoret vetëm në nivel qendror/federal në dy prej tyre (Spanjë dhe Zvicër). Gjeorgjia përdor një organizim buxhetor për

përcaktimin e objektit të konsolidimit në nivel qendror. Brazili publikon vetëm konsolidim në nivel federal, në bazë të ligjit të tij.

130. Poshtë nivelit qendror, konsolidimi mbi qasjen e kontrollit planifikohet të bëhet për shtetet dhe bashkitë braziliane dhe për sektorin rajonal dhe sektorin vendor spanjoll me më shumë se 50 mijë banorë duke filluar në 2022. Në Gjeorgji, edhe qeverisja vendore zbaton kritere buxhetore, ndërsa në Zvicër, konsolidimi poshtë nivelit qendror nuk është i detyrueshëm. Një pasqyrë financiare e konsoliduar përfshirë qeverisjen në nivel federal, nivel shteti dhe nivel bashkie, i njohur si konsolidimi i sektorit publik, nxirret vetëm në Brazil, sipas një qasjeje ligjore. Në Shtojcën 2 jepet një përmbledhje e konstatimeve kryesore lidhur me objektin e konsolidimit.

131. Procesi i konsolidimit, së paku në qeverisjen qendrore/federale të vendeve të analizuara, bëhet me metoda të ndryshme. Tre prej vendeve (Brazili, Spanja dhe Zvicra) i konsolidojnë pasqyrat financiare duke përdorur mjete të automatizuara, ndërsa njëri vend (Gjeorgjia) e bën në mënyrë manuale me tabela në Microsoft Excel.

132. Objekti i përpilimit të katër vendeve mbulon vetëm sektorin e qeverisjes dhe nënsektorët e tij, pra nuk del jashtë njësive institucionale jo krijuese të tregut. Paraqitja e fondeve të sigurimeve shoqërore, nga ana tjetër, ndryshon mes vendeve që i kanë (Brazili, Spanja dhe Zvicra). Për shembull, statistikat financiare qeveritare të Brazilit i paraqesin fondet e sigurimeve shoqërore si pjesë e secilit nënsektor, ndërsa të Zvicrës dhe Spanjës i paraqesin si një nënsektor më vete.

133. Asnjëri prej katër vendeve nuk përpilon dhe nuk publikon statistika financiare qeveritare për sektorin e ndërmarrjeve publike dhe nënsektorët e tij, që përfshijnë NSH-të krijuese të tregut dhe ndërmarrjet thuajse shoqëri tregtare, pavarësisht nëse janë financiare ose jo financiare. Për pasojë, nga asnjëri prej katër vendeve nuk përpilohen statistika financiare qeveritare të sektorit publik si i tërë, megjithëse Spanja i përpilonte deri në vitin 2017, ndërsa Zvicra ka në plan t'i përpilojë në të ardhmen. Në Shtojcën 2 jepet një përmbledhje e konstatimeve kryesore lidhur me objektin e përpilimit.

134. Procesi i përpilimit kryhet nga katër vende, duke përdorur burime të ndryshme për marrjen e të dhënave të njësive që duhet të përpilohen në secilin sektor dhe nënsektor, p.sh., të dhënat kontabël, modelet tip dhe anketat të standardizuara elektronike, të dhënat e nxjerra nëpërmjet teknikave statistikore dhe informacionet e njësive të tjera si banka qendrore dhe zyrat e statistikave. Për përpilimin e statistikave, përdoren disa aplikacione specifike, por procesi i konsolidimit bëhet kryesisht në mënyrë manuale me tabela në Microsoft Excel, me përjashtim të Zvicrës ku përdoren mjete të automatizuara.

135. Janë vërejtur shumë praktika të mira ndër katër vendet e studiuara.

1. Identifikimi i njësive që duhen konsoliduar/përpiluar.
2. Përdorimi i një plani kontabël të harmonizuar me GSFM-në, përfshirë zbrëthimin specifik për të identifikuar më lehtë transaksionet reciproke.
3. Verifikimi i përputhshmërisë së të dhënave.
4. Përqendrimi te ato njësi vlerat e të cilave janë materiale për pasqyrat financiare të konsoliduara.
5. Homogjenizimi i datës mbyllëse të pasqyrave financiare, parimeve kontabël dhe politikave nëpërmjet veprimeve rregulluese.
6. Identifikimi dhe eliminimi i transaksioneve reciproke.
7. Verifikimi i të dhënave të konsoliduara/përpiluara.
8. Modifikimi i të dhënave të konsoliduara kur pasqyrat financiare të njësive të konsoliduara ndryshojnë.
9. Përkthimi dhe publikimi i pasqyrave financiare të konsoliduara në gjuhë të ndryshme.
10. Përdorimi i mjeteve elektronike për të marrë të dhënat e njësive që do të përpilohen.
11. Ngritja e partneriteteve me njësi të tjera të cilat trajtojnë të dhënat plotësuese të nevojshme për procesin e përpilimit.

# 4

## PROCESI I INTEGRUAR I KONSOLIDIMIT DHE PËRPILIMIT

136. Në këtë krye paraqitet propozimi për një proces të integruar konsolidimi dhe përpilimi. Synimi i procesit të propozuar është zvogëlimi i disa prej vështirësive të vërejtura në proceset e konsolidimit dhe përpilimit nga vendet e analizuara. Prosesi i përpilimit kryhet zakonisht si proces i pavarur, pra zhvillohet duke përdorur si të dhëna hyrëse të dhënat kontabël, por lipset të mbledhë një gamë të gjerë informacionesh të tjera shtesë. Duke pasur parasysh dallimet konceptuale që ekzistojnë midis kuadrit kontabël dhe atij statistikor, mund të lindë nevoja për rregullime duke përdorur burime jo kontabël. Mirëpo, procesi i propozuar mund ta ulë numrin e rregullimeve të nevojshme dhe kompleksitetin e tyre.

137. Prosesi i propozuar përdor përvijimin e sektorit publik dhe nënsektorëve të tij të paraqitur në GFMS 2014 për të përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara, në vend të përvijimit të njësisë ekonomike nëpërmjet parimit të kontrollit sipas

SNKSP 35. Për këtë, procesi i sugjeruar integron aktivitetet e paraqitura në **Figurën 6** dhe **Figurën 7** që janë diskutuar në **Pikat 2.4** dhe **2.5**. Me fjalë të tjera, ai integron aktivitetet e nevojshme për procesin e konsolidimit sipas SNKSP-ve, pa marrë në konsideratë parimin e kontrollit, si edhe aktivitetet thelbësore për procesin e përpilimit sipas GFMS 2014. Prosesi i integruar i konsolidimit dhe përpilimit shpjegohet në **Figurën 8**.

138. Prosesi i propozuar i konsolidimit dhe përpilimit i ilustruar në **Figurën 8** ka katërmbëdhjetë hapa të grupuar në gjashtë faza: i) përgatitja fillestare sipas kuadrit statistikor; ii) mirëmbajtja dhe puna përgatitore sipas standardeve të kontabilitetit dhe kuadrit statistikor; iii) konsolidimi i të dhënave financiare sipas standardeve të kontabilitetit; iv) raportimi financiar sipas standardeve të kontabilitetit; v) përpilimi i të dhënave statistikore; dhe vi) raportimi statistikor. Në pikat në vijim, shpjegohet secili hap.

**Figura 8.** Procesi i integruar i konsolidimit dhe përpilimit



Burimi: Ekipi i Bankës Botërore

## 4.1. Faza 1: Përgatitja fillestare sipas kuadrit statistikor

### 4.1.1. Hapi 1: Përvijimi i sektorit të qeverisjes së përgjithshme dhe sektorit publik dhe i nënsektorëve të tyre nëpërmjet klasifikimit sektorial

139. Në vend të përcaktimit të objektit të konsolidimit të pasqyrave financiare në bazë të njësisë ekonomike, siç e kërkon SNKSP 35 dhe siç ilustruhet në hapin e parë të **Figurës 6**, procesi i integruar që propozon ky dokument teknik sugjeron përcaktimin dhe zgjerimin e objektit të sektorit publik dhe nënsektorëve të tij sipas GFSM 2014, siç bëhet në përpilimin e statistikave financiare qeveritare në hapin e parë të **Figurës 7**. Zgjerimi i objektit të konsolidimit të pasqyrave financiare për të përfshirë sektorin publik dhe nënsektorët e tij sipas GFSM 2014 zakonisht çon në rritjen e numrit të njësive për t'u konsoliduar, qoftë edhe pas heqjes së njësive jo rezidente, në krahasim me numrin e njësive sipas objektit të përcaktuar në kriteret e SNKSP 35.

## 4.2. Faza 2: Mirëmbajtja dhe puna përgatitore sipas standardeve të kontabilitetit dhe kuadrit statistikor

### 4.2.1. Hapi 2: Përgatitja e një plani kontabël të harmonizuar me kuadrin kontabël dhe kuadrin statistikor

140. Zgjerimi i objektit të konsolidimit të pasqyrave financiare për të përfshirë sektorin publik dhe nënsektorët e tij sipas GFSM 2014 mund të thotë edhe

që një numër më i madh njësish zbatojnë korniza të ndryshme rregullore të kontabilitetit dhe përdorin plane kontabël të ndryshme. Për të mbledhur informacionet financiare si nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme të çdo niveli qeverisjeje, ashtu edhe nga shoqëritë publike, për qëllimet e raportimit duhet të ekzistojë së paku një plan kontabël i unifikuar dhe i harmonizuar. Siç është shpjeguar në hapin e dytë të **Figurave 6** dhe **7**, struktura dhe nomenklatura e këtij plani kontabël do të duhej të mbante parasysh spektrin e gjerë të funksioneve, aktiviteteve dhe operacioneve të secilës njësi, kornizat e ndryshme rregullore të kontabilitetit që ato përdorin dhe një klasifikim i cili përfshin kërkesat e raportimit buxhetor, kontabël dhe statistikor.

### 4.2.2. Hapi 3: Kujdesi për të përdorur të njëjtat politika kontabël

141. Në një vend të vetëm, mund të ndodhë që të bashkekzistojnë disa korniza kontabël të zbatueshme për qeverinë dhe njësitë e tjera të sektorit publik, në varësi të autonomisë, madhësisë, natyrës, qëllimit, funksioneve ose aktiviteteve të tyre (p.sh., NSH-të përdorin SNRF-të ose standardet kombëtare të kontabilitetit të sektorit privat, qeverisja qendrore përdor SNKSP-të ose standarde kombëtare të KSP-së, ndërsa njësitë e qeverisjes poshtë nivelit qendror përdorin një kornizë të thjeshtuar rregullore kontabiliteti të mbështetur në SNKSP, SNRF ose ndonjë standard tjetër kontabiliteti). Rrjedhimisht nevojitet të përcaktohen bazat e kontabilitetit, parimet kontabël dhe kriteret për hartimin dhe paraqitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara për sektorin publik dhe nënsektorët e tij dhe të miratohen strategji të ndryshme për marrjen e informacioneve me cilësitë e nevojshme (p.sh., raporte financiare sipas SNKSP-ve kur janë të ndryshme politikat kontabël sipas SNRF-ve).

142. Në vendet me sistem unitar të centralizuar, ku qeverisja qendrore është autoriteti më i lartë i cili kontrollon të gjitha njësitë prej të cilave përbëhet sektori publik, një strategji e mundshme do të ishte nxjerrja e një pakete të detyrueshme udhëzuese për mbylljen e llogarive dhe raportimin, siç shpjegohet për hapin e tretë të **Figurës 6**. Mirëpo, në vendet me sistem unitar federal ose të decentralizuar, ku njësitë e qeverisjes poshtë nivelit qendror janë autonome

dhe ato vetë apo njësitë e tyre nuk janë nën kontrollin e nivelit qendror, një paketë e tillë do të duhej të miratohej me marrëveshje pasi të jenë shpjeguar përparësitë e hartimit dhe paraqitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara për sektorin publik dhe nënsektorët e tij.

### 4.2.3. Hapi 4: Kujdesi për të përdorur të njëjtën datë ndarëse për pasqyrat financiare

143. Gjatë hartimit të pasqyrave financiare të konsoliduara për sektorin publik dhe nënsektorët e tij, siç është shpjeguar për hapin e katërt të **Figurës 6**, do të duhej të sigurohej që periudha ushtrimore dhe data ndarëse e pasqyrave financiare ose raporteve të veçanta të njësive raportuese të përkonte me periudhën ushtrimore ose datën ndarëse që është vendosur për paraqitjen e informacioneve të konsoliduara.

144. Siç ndodh në mungesë të politikave kontabël të njëtrajtshme, në vendet me sistem unitar të centralizuar, një strategji e mundshme për të siguruar që periudha ushtrimore dhe data ndarëse të jenë të njëjta për pasqyrat financiare ose raportet e veçanta dhe për pasqyrat financiare të konsoliduara do të ishte nxjerrja e një udhëzimi për mbylljen e llogarive dhe raportimin. Në këtë mënyrë, do të ishte e mundshme të shmangeshin kërkesa shtesë për informacione dhe ndërlikimi i kryerjes së veprimeve rregulluese në procesin e konsolidimit. Mirëpo, në vendet me sistem unitar federal ose të decentralizuar, këto masa do të duhej të ishin me konsensus.

### 4.2.4. Hapi 5: Zhvillimi dhe përditësimi i sistemeve ose lidhja e algoritmeve për konsolidimin dhe përpilimin

145. Në dallim nga procesi i konsolidimit të mbështetur në parimin e kontrollit, siç ilustron **Figurën 6**, ku një njësi kontrolluese mund të ushtrojë fuqinë e vet mbi njësitë e kontrolluara për t'i detyruar të përdorin një sistem informativ unik, siç është SIIMF, për t'i kryer më lehtë veprimet rregulluese të konsolidimit, procesi i integruar i propozuar në këtë

dokument teknik parashikon se kjo situatë ideale do të ishte e vështirë të arrihej, sidomos në vendet me sistem unitar federal ose të decentralizuar, ku njësitë e qeverisjes nën nivelin qendror janë autonome dhe ato dhe njësitë e tyre nuk janë nën kontrollin e nivelit qendror.

146. Për të mbledhur dhe analizuar të dhënat nga të gjitha njësitë e sektorit publik, do të duhej të projektohej dhe zbatohet një sistem informativ unik, siç është SIIMF-ja, vetëm në ata nënsektorë ku është e mundur. Për nënsektorët e tjerë, duhet vënë në dispozicion së paku një sistem për qëllime raportimi, me algoritme ose tabela urë për veprimet rregulluese të konsolidimit dhe përpilimit.

## 4.3. Faza 3: Konsolidimi i të dhënave financiare sipas standardeve të kontabilitetit

### 4.3.1. Hapi 6: Mbledhja e të dhënave të njësive

147. Në vendet me sistem unitar të centralizuar, ku qeverisja qendrore është autoriteti më i lartë i cili kontrollon të gjitha njësitë prej të cilave përbëhet sektori publik, mbledhja e të dhënave të njësive, në rastin ideal, do të duhej të bëhej duke ndjekur qasjen e centralizuar që shpjegohet në hapin e gjashtë të **Figurës 6**. Ndërkohë, në vendet me sistem unitar federal ose të decentralizuar, ku njësitë e qeverisjes poshtë nivelit qendror janë autonome dhe ato vetë apo njësitë e tyre nuk janë nën kontrollin e nivelit qendror, do të preferohej që mbledhja e të dhënave të gjurmohet përmes një qasjeje hibride publik, siç shpjegohet në hapin e gjashtë të **Figurës 6**.

### 4.3.2. Hapi 7: Verifikimi i përputhshmërisë së të dhënave të mbledhura

148. Siç shpjegohet për hapin e shtatë të **Figurës 6**, është e nevojshme që, pas mbledhjes së të dhënave të njësive, të bëhen kontrolle të cilësisë dhe



pranueshmërisë, p.sh., duke verifikuar përdorimin e saktë të llogarive, klasifikimin e saktë të veprimeve dhe inventarëve të aktiveve dhe detyrimeve, duke bërë verifikime të vlerave, rakordime dhe kontrole të transaksioneve reciproke, për të parë se mos ka mospërputhje materiale dhe, nëse ka të tilla, për të informuar njësinë përkatëse në mënyrë që ajo të bëjë rregullimet në informacionet e veta financiare.

### 4.3.3. Hapi 8: Kryerja e rregullimeve të konsolidimit

149. Megjithëse objekti i pasqyrave financiare të konsoliduara për sektorin publik dhe nënsektorët e tij nuk përputhjet me objektin e parashikuar në SNKSP 35, rregullimet e konsolidimit do të duhej të bëheshin në përputhje me këtë standard. Për rrjedhojë, nevojitet: i. kombinimi ose bashkimi i zërave të aktiveve, detyrimeve, aktiveve/kapitalit neto, të ardhurave, shpenzimeve dhe flukseve monetare të të gjitha njësive prej të cilave përbëhet sektori publik ose nënsektorët e tij; ii. kompensimi ose eliminimi i vlerës kontabël neto të investimit të të gjitha njësive kontrolluese në çdo njësi të kontrolluar me pjesën e aktiveve/kapitalit neto të njësisë kontrolluese të secilës njësi të kontrolluar; dhe iii. eliminimi i plotë i tepricave dhe transaksioneve reciproke. Për të kryer këto rregullime duhen përdorur sistemet, algoritmet ose tabelat urë të zhvilluara në hapin e pestë të këtij procesi të integruar dhe të përshkruara në **Pikën 4.2.4.**

### 4.3.4. Hapi 9: Verifikimi i rezultateve të përftuara

150. Me të njëjtën frymë siç shpjegohet në hapin e nëntë të **Figurës 6**, pas konsolidimit të të dhënave, duhen kryer veprimet e kontrollit të cilësisë, siç është verifikimi për t'u siguruar që nuk ka transaksione ose teprica për t'u rakorduar, kontrollimi i përputhshmërisë së shumave të vlerave të konsoliduara dhe shqyrtimi i ndryshimeve në llogari. Për të kryer këto aktivitete, duhen përdorur sistemet, algoritmet ose tabelat urë të zhvilluara në hapin e pestë të këtij procesi të integruar dhe të përshkruara në **Pikën 4.2.4.**

## 4.4. Faza 4: Raportimi financiar sipas standardeve të kontabilitetit

### 4.4.1. Hapi 10: Prodhimi i pasqyrës financiare të konsoliduar të sektorit publik, sektorit të qeverisjes së përgjithshme dhe të nënsektorëve të tyre

151. Në mënyrë të ngjashme me shpjegimin e hapit të dhjetë të **Figurës 6**, në këtë hap hartohen informacionet shpjeguese, tabelat manuale dhe informacionet e tjera plotësuese që shoqërojnë pasqyrat financiare për sektorin publik dhe nënsektorët e tij. Duhet kryer veprime të kontrollit të cilësisë për të verifikuar pranueshmërinë e teksteve dhe tabelave të përgatitura në mënyrë manuale. Kur të jetë i gatshëm i një version përfundimtar i pasqyrave financiare të konsoliduara për sektorin publik dhe nënsektorët e tij, ky duhet të marrë miratimin e autoritetit përkatës dhe të publikohet.

## 4.5. Faza 5: Përpilimi i të dhënave statistikore

### 4.5.1. Hapi 11: Kalimi nga të dhënat kontabël te ato statistikore

152. Të dhënat e paraqitura në pasqyrat financiare të konsoliduara për njësitë qeveritare të sektorit të qeverisjes së përgjithshme dhe nënsektorët e tij konvertohen ose kalohen në përputhje me formatet e përcaktuara në kornizat statistikore të referimit (p.sh., konvertimi i shpenzimeve nga zhvlerësimi për shkak të amortizimit fizik të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, nga pasqyra e konsoliduar përkatëse e performancës financiare në pasqyrën e flukseve të tjera ekonomike të sektorit publik ose të nënsektorëve të tij).

153. Për të bërë këtë kalim nga të dhënat kontabël në të dhënat statistikore, duhen përdorur sistemet, algoritmet ose tabelat urë të zhvilluara në hapin e pestë të këtij procesi të integruar dhe të përshkruara në **Pikën 4.2.4**. Krahas kësaj, nëse një vend i paraqet statistikatat financiare qeveritare të veta duke përdorur më shumë se një kornizë statistikore referimi, mund të përdorë qasjen e përpunimit hap pas hapi ose qasjen e përpunimit paralel, që shpjegohen në Udhëzuesin e krahasimit.

## 4.5.2. Hapi 12: Kryerja e rregullimeve statistikore

154. Pas kalimit në statistikatat financiare qeveritare, duhen bërë disa veprime rregulluese për të vlerësuar flukset ekonomike si edhe aktivet, detyrimet dhe vlerën neto sipas çmimeve aktuale të tregut. Krahas kësaj, është e nevojshme të riorganizohen disa transaksione për të nxjerrë në pah më qartë raportin e tyre ekonomik bazë. Për këtë qëllim, duhen bërë tre lloje riorganizimesh për statistikatat financiare qeveritare: i. devijimi, p.sh., kur një njësi e sektorit publik i paguan drejtpërdrejt fondit të sigurimeve shoqërore një kontribut i cili është pjesë e pagës së punëmarrësve, ky veprim duhet të paraqitet në statistikatat financiare qeveritare si një komponent i pagës së punëmarrësve; ii. ndarja, p.sh., kur një njësi e sektorit publik blen një aktiv me vlerë më të vogël ose më të madhe se çmimi aktual i tregut, ky veprim duhet të ndahet në një veprim me këmbim vlere dhe në një veprim dërgese; dhe iii. ricaktimi, p.sh., kur ka një veprim në kuadër të një marrëdhënieje agjencie, ky veprim duhet të identifikojë llogaritë e dy palëve të përfshira në veprim dhe jo llogaritë e palës së tretë që mundëson veprimin (GFSM 2014, paragrafët 3.28 deri 3.30).

## 4.5.3. Hapi 13: Kontrolli i përputhshmërisë së GFS-ve të përpiluara

155. Pasi të jenë bërë veprimet rregulluese statistikore, duhen bërë aktivitetet e kontrollit të cilësisë së statistikave financiare qeveritare, siç është kontrolli i kryqëzuar i simetrisë midis nënsektorëve

të ndryshëm të sektorit publik dhe sektorëve të tjerë të ekonomisë dhe verifikimi i shumës së identiteteve horizontale (pra, i tepricave financiare në fillim të periudhës ushtrimore plus transaksionet, rivlerësimet dhe ndryshimet e tjera të vëllimit të aktiveve dhe detyrimeve gjatë së njëjtës periudhë duhet të jenë të barabarta me tepricat në mbyllje të periudhës ushtrimore). Sistemet, algoritmet urë ose tabelat e zhvilluara në hapin e pestë të procesit të integruar, që përshkruhen në **Pikën 4.2.4** do të ishin të dobishme për kontrollin e kryqëzuar midis nënsektorëve të ndryshëm të sektorit publik dhe për verifikimin e shumës së vlerave horizontale. Mirëpo, gjatë kontrollit të kryqëzuar të simetrisë me sektorët e tjerë të ekonomisë, do të ishte e dëshirueshme lidhja e partneriteteve me njësi të tjera të cilat trajtojnë të dhëna plotësuese.

## 4.6. Faza 6: Raportimi statistikor

### 4.6.1. Hapi 14: Krijimi i produkteve statistikore

156. Pasi bëhet gati versioni përfundimtar i statistikave financiare qeveritare të përpiluara në përputhje me kornizën statistikore të referimit, këto duhen publikuar dhe më pas duhen dorëzuar për qëllime raportimi pranë organizatave ndërkombëtare ose rajonale, siç janë FMN-ja ose Eurostati. Nëse një vend i paraqet statistikatat financiare qeveritare të veta duke përdorur më shumë se një kornizë statistikore referimi (p.sh., i paraqitet paralelisht statistikatat financiare qeveritare duke përdorur edhe formularë të GFSM 2014, edhe formularë të ESA 2010) dhe përdor qasjen e përpunimit hap pas hapi që shpjegohet në Udhëzuesin e krahasimit, duhet përdorur versioni përfundimtar i statistikave financiare qeveritare të përpiluara sipas kornizës së parë statistikore të referimit për të nxjerrë statistikatat financiare qeveritare të përpiluara sipas kornizave të tjera statistikore të referimit.



# 5

## PËRFUNDIME, REKOMANDIME, VËSHTIRËSI DHE MASA ZBUTËSE

### 5.1. Përfundime

157. Pasqyrat financiare të konsoliduara, në krahasim me pasqyrat financiare të veçanta të një subjekti juridik, përfshijnë disa njësi të cilat janë të ndërlidhura nga aspekti juridik. Ndryshe nga pasqyrat financiare të veçanta, ato nuk u japin përgjigje pyetjeve juridike, por atyre ekonomike. Për rrjedhojë, ato zakonisht zëvendësojnë pasqyrat financiare të veçanta të kërkuara me ligj, por ofrojnë edhe disa informacione shtesë përmes përfshirjes së disa njësive në të ashtuquajturën “njësi ekonomike”.

158. Informacione të tilla ekonomike shtesë janë të nevojshme sepse struktura organizative e qeverive, qoftë edhe në vende të vogla, përfshin disa subjekte juridike të cilat të varura ekonomikisht. Varësia

ekonomike mund të lidhet me financimin nëpërmjet të ardhurave fiskale ose nëpërmjet borxhit shtetëror, përgjithësisht të administruar brenda një buxheti të përpiluar dhe zbatuar nga pushteti ekzekutiv dhe të miratuar nga pushteti legjislativ. Por mund të ketë lidhje gjithashtu edhe me rreziqet e mundshme financiare dhe operative ndaj të cilave zbulohet qeveria, por të cilat jo gjithmonë realizohen, për shembull në rastin e një krize ose në qoftë se njësia nuk po ecën siç pritet. Shpesh bëhen dërgesa periodike ose jo periodike ndërmjet njësive të varura ekonomikisht, që mund të krijojë disa informacione shtrembëruese/të paplota në nivel njësie.

159. Për rrjedhojë, është praktikë e mirë të hartohen dhe paraqiten pasqyra financiare të konsoliduara të cilat paraqesin një grup ekonomik njësisish si të ishin

një njësi e vetme. Objekti mund të ndryshojë mes vendeve dhe varet nga nevojat për informacion të përdoruesve dhe nga standardet e zbatuara. Është po ashtu e mundshme që të ekzistojnë më shumë se një objekt dhe, për rrjedhojë, më shumë se një pasqyrë financiare e konsoliduar, për t'iu përgjigjur nevojave të ndryshme për informacion (p.sh., një për njësitë buxhetore dhe një më e madhe që përfshin NSH-të).

160. Statistikat financiare qeveritare janë gjithashtu rezultat i një procesi konsolidimi, megjithëse nuk e përdorin konceptin e njësive ekonomike, konceptin e njësive institucionale dhe sektorëve ekonomikë. Kjo lejon edhe zbatimin e çmuarjeve dhe rregullimeve statistikore. Kjo çon në një nivel më të lartë materialiteti në krahasim me pasqyrat financiare të njësisë ekonomike. Me fjalë të tjera, statistikat përfshijnë sektorë të tërë por janë më pak precize se pasqyrat financiare të konsoliduara. Proceset e konsolidimit dhe përpilimit janë, për rrjedhojë, të ngjashme por jo identike.

161. Si përfundim, si pasqyrat financiare të konsoliduara, ashtu edhe statistikat financiare qeveritare u përgjigjen nevojave konkrete për informacion që nuk përmbushen nga pasqyrat financiare individuale të njësive juridike. Ato paraqesin informacion ekonomik, përkatësisht për njësi ekonomike dhe sektorë ekonomikë. Një informacion i tillë është i nevojshëm për shkak të varësive ekonomike ndërmjet njësive të veçanta. Përkufizimi i objektit të pasqyrave financiare të konsoliduara dhe i objektit të statistikave financiare qeveritare varet nga nevojat për informacion dhe nga standardet e përdorura.

## 5.2. Rekomandime

162. Ky dokument teknik rekomandon vënien në zbatim të një procesi të integruar konsolidimi dhe përpilimi, që propozohet dhe përshkruhen në **Pikën 4**. Ky rekomandim vjen si një alternativë e mundshme për të zbutur vështirësitë e konsolidimit dhe përpilimit të informacionit, siç është vënë në pah edhe nga përgjigjet e pyetësorit.

163. Procesi i propozuar kërkon një nivel të lartë ndërveprimi ndërmjet sektorëve të kontabilitetit dhe të statistikave, sepse propozimi kërkon të fusë në një proces unik raportimin financiar sipas standardeve të kontabilitetit dhe raportimin statistikor sipas

kornizës statistikore. Mirëpo, këta sektorë zakonisht janë të pavarur nga njëri-tjetri dhe kanë objektiva dhe procedura të ndryshme. Për të vënë në zbatim procesin e propozuar, lipset ndërgjegjësimit, ngritje e kapaciteteve dhe bashkëpunim, si edhe një bashkërendim dhe integrim i fortë i funksioneve. Rekomandohet organizimi dhe bashkimi i nismave të formimit për specialistët e kontabilitetit dhe të statistikave në shtet, me qëllim krijimin e aftësive më homogjene që të jenë të dobishme për vënien në zbatim të procesit të propozuar.

164. Vënia në zbatim e procesit të propozuar kërkon bashkërendim me një numër të madh njësish, nëse mbajmë parasysh strukturën e qeverive. Kryerja e këtij bashkërendimi mund të kërkojë një kohë të caktuar, për të arritur integrimin dhe publikimin e pasqyrave të plota të të gjitha njësive. Gjatë kësaj periudhe, rekomandohet t'i kushtohet vëmendje e veçantë bërjes së transparencës lidhur me objektin dhe qëndrimin për pasqyrat e konsoliduara.

165. Informacioni i konsoliduar ose i përpiluar kërkon përfshirjen e një bashkësie njësish. Për arritjen e kuptueshmërisë së informacionit për përdorues të ndryshëm, është e nevojshme të kategorizohen njësitë dhe të shpjegohet futja e këtyre njësive në strukturën e qeverisë dhe raporti i tyre me buxhetin e shtetit. Duhet bërë e ditur teknika kontabël ose kriteri i përdorur për konsolidimin ose përpilimin e njësisë. Ka shumë dallime mes njësive nga njëri vend në tjetrin, dhe ky shpjegim mund të jetë thelbësor për arritjen e kuptueshmërisë.

166. Disa rekomandime më konkrete shtesë jepen më poshtë, në formë të përmbledhur:

1. Lipsen administruar aktivisht proceset e konsolidimit dhe përpilimit, sepse këto procese nuk mund të merren si të mirëqena dhe administrimi i tyre mund ta zvogëlojë kompleksitetin e tyre dhe ta rritë cilësinë e informacionit të prodhuar përmes marrjes së masave të duhura.
2. Si hap i parë i procesit të konsolidimit/përpilimit, me rëndësi kritike është identifikimi i bashkësisë së njësive që do të përfshihen në konsolidim/përpilim.
3. Është e rëndësishme të zhvillohet dhe përdoret një plan kontabël i harmonizuar me GFSM-në mes të gjitha njësive që do të përfshihen në konsolidim/përpilim, që, nga ana e saj, duhet të përfshijë informacione të zberthyer për të

- identifikuar më lehtë transaksionet e mundshme reciproke midis njësive.
4. Është e rëndësishme të sigurohet harmonizimi i datave ndarëse të pasqyrave financiare, parimeve kontabël/statistikore dhe politikave.
  5. Të zhvillohet dhe vihet në zbatim një SIIMF dhe të sigurohet që të përdoret nga sa më shumë njësi nga ato që do të përfshihen në konsolidim/përpilim.
  6. Të kontrollohet mirë përputhshmëria e të dhënave financiare fillestare me informacionin e konsoliduar/përpiluar.
  7. Duhet përqendruar vëmendja te ato njësi vlerat e të cilave janë materiale për pasqyrat financiare të konsoliduara.
  8. Të sigurohet identifikimi dhe eliminimi siç duhet i transaksioneve reciproke.

9. Të përditësohet në kohën e duhur informacioni i konsoliduar kur ndryshojnë pasqyrat financiare.

## 5.3. Vështirësitë dhe masat zbutëse

167. Vënia në zbatim e procesit të integruar për konsolidimin dhe përpilimin, që propozohet këtu, mund t'u sjellë disa vështirësi qeverive. Disa vështirësi të mundshme jepen dhe përshkruhen në **Tabelën 2**. Secila vështirësi kërkon një analizë që merr parasysh veçantitë e vendeve, në mënyrë që të arrihet një zgjidhje. Por në **Tabelën 2** jepen edhe shembuj të masave zbutëse.

**Tabela 2.** Vështirësi të mundshme dhe masat zbutëse në vënien në zbatim të procesit të integruar të konsolidimit dhe përpilimit që propozohet

#	Vështirësitë	Masat zbutëse
1	<b>Organizimi kushtetues.</b> Në vendet federale dhe në disa vende me nivel të lartë decentralizimi, do të ishte e vështirë marrja e të dhënave të njësive në nivelin qendror.	Duhet filluar me vënien në zbatim në nivel qendror dhe pastaj të përfshihet qeverisja në nivelin qendror me anë të një marrëveshjeje. Përfshirja e njësive të qeverisjes në nivelin qendror mund të bëhet nëpërmjet një qasjeje me nivele ose me grupe. Kjo kërkon një bashkërendim të mirë midis aktorëve (p.sh., politikanëve dhe burokratëve) dhe një planifikim të kujdesshëm për të përcaktuar rendin e përfshirjes së njësive (p.sh., në fillim fokusi të jetë te njësitë me vlera të konsiderueshme të cilat ndikojnë në analizën buxhetore dhe pastaj njësitë e tjera). Ndryshimet e planifikimit mund të sjellin pasiguri dhe të dekurajojnë njësitë që të mos bashkëpunojnë. Ky proces duhet të planifikohet mirë, për të marrë legjitimitetin e pjesëmarrësve.  Është e mundshme që në disa faza, konsolidimi të mos përfshijë të gjitha njësitë që do të duhej të mbulohehin. Kur të ndodhë kjo, është e rëndësishme të jepet informacion për njësitë e përfshira dhe për ato jo të përfshira.
2	<b>Kërkesat ligjore.</b> Në disa vende, objekti i pasqyrave financiare të konsoliduara dhe aktivitetet, metodikat dhe procedurat e konsolidimit janë të përcaktuara në kornizën ligjore. Çdo ndryshim kërkon miratim legjislativ, në disa raste, mbi nivelin qendror të vendit (siç është rasti i Bashkimit Evropian).	T'u tregohet politikanëve se cilat janë përfitimet e procesit të integruar të konsolidimit dhe përpilimit në kuadër të zvogëlimit të vështirësive dhe përpilimit të statistikave financiare qeveritare, për të modifikuar kërkesat ligjore aktuale.

#	Vështirësitë	Masat zbutëse
3	<p><b>Vëllim i madh njësisish dhe operacionesh.</b> Për shkak të strukturës së qeverisjes, mund të ketë shumë njësi dhe operacione të cilat lipset të konsolidohen/përpilohen. Numri i madh i njësive mund të shkaktojë interpretime të ndryshme dhe vonesa në marrjen e të dhënave nëse procesi nuk është i organizuar mirë dhe i harmonizuar mes palëve të ndryshme. Mosprogramimi mund të sjellë përfshirjen e të dhënave të cilat nuk janë audituar dhe rregulluar pas auditimit. Kjo mund të cenojë cilësinë e të gjithë procesit.</p>	<p>Përdorimi i një procesi elektronik për nxjerrjen e pasqyrave dhe dhënien e informacione shtesë. Është thelbësore që të gjitha njësitë të harmonizohen me procesin. Për të arritur harmonizimin, mund të jetë e nevojshme: i. të zhvillohen seminare dhe formime të rregullta në nivele të ndryshme të qeverisjes; dhe ii. të përgatiten metoda, manuale, udhëzime dhe modele tip kontabiliteti dhe raportimi. Të sigurohet që veçantitë e njësive do të marrin zgjidhje në formimet dhe materialin e formimit.</p> <p>Është po kështu e rëndësishme të vendosen afate për marrjen e të dhënave. Duhet treguar kujdes që afatet të jenë realiste, për të shmangur sa më shumë ndryshimet dhe që afatet të përfshijnë marrjen e të dhënave që janë audituar dhe që të bëhen siç duhet rregullimet e nevojshme pas auditimit. Duhet legjitimuar ky proces në mënyrë që njësitë t'i respektojnë afatet e vendosura. Në disa raste mund të vendosen sanksione për mosrespektimin, por është e rëndësishme që njësitë ta kuptojnë rëndësinë e procesit në mënyrë që të mos merret vetëm si detyrim.</p>
4	<p><b>Politika kontabël të ndryshme.</b> Në një vend të vetëm, mund të ketë disa korniza dhe politika kontabël të zbatueshme për njësitë e qeverisjes dhe njësitë e tjera të sektorit publik.</p>	<p>Nxjerrja e udhëzimeve dhe modeleve tip për mbylljen e llogarive, për të marrë informacion sipas të njëjtës kornizë dhe politikave kontabël.</p> <p>Në rastet kur legjislacioni nuk kërkon përgatitjen dhe dhënien e informacionit të nevojshëm për të përmbushur nevojat e procesit të integruar të konsolidimit dhe përpilimit, është e rëndësishme të sigurohet që njësitë raportuese të mos e marrin si barrë procesin. Për ta shmangur këtë, mund të jetë i dobishëm një bashkërendim i ngushtë dhe vendosja e strategjive për ndarjen e kostove të mundshme shtesë. Mosveprimi për të pasur një mekanizëm për ndarjen e kostove mund të krijonte rezistencë ndaj ndryshimit dhe të vinte në rrezik suksesin e zbatimit.</p>
5	<p><b>Mungesë e një plani kontabël të unifikuar dhe harmonizuar për të raportuar informacionin.</b> Disa vende nuk kanë miratuar ende një plan kontabël të zbatueshëm për të gjitha njësitë e sektorit publik dhe të harmonizuar me kornizën statistikore të referimit.</p>	<p>Miratimi i një plani kontabël të unifikuar dhe të harmonizuar për të raportuar informacionin, miratimi i një strukture dhe nomenklature që përmbush kërkesat për raportim të kornizave buxhetore, kontabël dhe statistikore të referimit. Duhet siguruar që të bëhen përherë përditësimet në kohën e duhur, duke mbajtur parasysh nevojat e mundshme. Krahas kësaj, formimi mbi standardet e zbatuara të kontabilitetit për kontabilistët e sektorit publik në nivelet e ndryshme të qeverisjes mund të ndihmojë në përdorimin e saktë të planit kontabël të miratuar.</p>

#	Vështirësitë	Masat zbutëse
6	<b>Përdorim i sistemeve të ndryshme kontabël ku disave syresh u mungojnë kërkesat minimale të sistemit.</b> Disa njësi që duhet të konsolidohen mund të përdorin sisteme të ndryshme kontabël, me strukturë dhe teknologji jo të standardizuara, dhe disave syresh mund t'u mungojnë kërkesat minimale të sistemit.	Kjo vështirësi mund të marrë zgjidhje përmes ndërtimit të aplikacioneve të duhura dhe pyetësorëve për të marrë informacione plotësuese të standardizuara dhe telematike. Një masë tjetër zbutëse është përdorimi i një sistemi të centralizuar kontabël për nxjerrjen e të dhënave të nevojshme.  Në përgjigje të mungesës së kërkesave minimale të sistemit, një zgjidhje e mundshme është miratimi i rregullave në lidhje me kërkesat minimale për sistemet.
7	<b>Mungesë e një sistemi ose një algoritmi urë për konsolidimin dhe përpilimin.</b> Disa vende nuk kanë një sistem të automatizuar, si një SIIMF, apo një algoritëm urë për të kryer proceset e konsolidimit dhe përpilimit. Dy janë arsyt kryesore. Së pari, mungesa e harmonizimit të politikave kontabël dhe planit kontabël e vështirësojnë konfigurimin e një sistemi të tillë. Së dyti, një sistem i tillë mund të kërkojë një investim të konsiderueshëm financiar.	Rekomandohet harmonizimi i politikave kontabël dhe planit kontabël, si parakusht, dhe shqyrtimi i idesë së mekanizmave të ndryshëm financues për të përgatitur dhe zbatuar në një sistem të automatizuar, si një FIIMS, ose një algoritëm urë për të kryer proceset e konsolidimit dhe përpilimit, përfshirë zhvillimin brenda institucionit, dhe për të përdorur një zgjidhje pa pagesë të gatshme në treg.
8	<b>Rregullimet statistikore.</b> Megjithëse pasqyrat financiare të konsoliduara hartohen duke mbajtur parasysh objektin e GFSM 2014, mund të ketë ende dallime mes standardeve të kontabilitetit dhe rregullave të statistikave lidhur me njohjen dhe matjen e transaksioneve ekonomike.	Ofrimi i formimit për kontabilistët e sektorit publik në nivele të ndryshme të qeverisjes, për kornizën statistikore të zbatuar, do t'i ndihmonte të bënin rregullimet e nevojshme. Gjithashtu, me vlerë për trajtimin e rregullimeve statistikore do të ishte edhe përgatitja e metodikave, manualeve dhe udhëzimeve.
9	<b>Mospërputhja midis të dhënave të marra nga njësitë e ndryshme.</b> Është e mundshme që, për arsye të ndryshme, njësi të ndryshme të dërgojnë të dhëna të ndryshme lidhur me të njëjtin transaksion të ndodhur mes tyre.	Ajo sugjeron të analizojë me kujdes të dhënat e marra dhe të identifikojë çdo mospërputhje të mundshme. Nëse një identifikim i tillë nuk është i mundshëm, alternativa mund të ishte të merrej vendim se cili informacion duket si më i besueshëm. Zakonisht, informacioni që vjen nga qeverisjes e nivelit më të lartë është më i besueshëm se ai i niveleve më të ulëta të qeverisjes. Për aktivet dhe detyrimet financiare, zakonisht informacioni i kreditorëve është më i saktë.
10	<b>Rezistenca për shkak të procesit tradicional të përdorur.</b> Në disa vende, raportimi financiar dhe statistikor bëhet nga njësitë administrative ose njësitë të cilat normalisht janë të veçuara, me objektiva dhe procedura të ndryshme.	Ofrimi i aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve për nëpunësit e kontabilitetit dhe të statistikave në qeveri do të mund të kontribuonte në krijimin e aftësive më homogjene, që janë të dobishme për vënien në zbatim të procesit të propozuar. Do të nevojiten aktiviteteve të mëtejshme të përhapjes së njohurive, ndërgjegjësimit dhe punës afruese, për të ndihmuar vënien në zbatim të procesit të propozuar.

# SHTOJCA

# 1

## PYETËSORI I DËRGUAR VENDEVE PËR TË MBLEDHUR INFORMACION

### Pjesa 1: Procesi i konsolidimit të pasqyrave financiare

1. Si kryhet procesi i konsolidimit të pasqyrave financiare në çdo nivel të qeverisjes?

Ju lutemi, mendoni për aspektet e mëposhtme:

- Njësia përgjegjëse për kryerjen e procesit të konsolidimit (në nivelin qendror dhe nën nivelin qendror)
- Objekti i konsolidimit: Llojet e njësive të mbuluara (p.sh., ministri, agjenci, institucione jofitimprurëse, legjislativi dhe gjyqësori, universitete, ndërmarrje shtetërore etj.)
- Kriteret e përdorura për përcaktimin e objektit: parimi i kontrollit (si në SNKSP 35)/kërkesat ligjore ose kushtetuese (p.sh., sektori buxhetor)
- Kuadri rregullator i kontabilitetit: (Përshkrim i organit të vendosjes së standardeve në nivel qendror/nën nivelin qendror. Korniza rregullatore mbështetet në SNKSP/SNRF apo në ndonjë standard tjetër? Korniza rregullatore zbatohet për çdo nivel të qeverisjes apo është e ndryshme për nivele të ndryshme të qeverisjes?)
- Përshkrim hap pas hapi i procesit të konsolidimit.
- Instrumentet informatike të përdorura për kryerjen e procesit: (I njëjti instrument informatik përdoret për çdo nivel të qeverisjes apo është i ndryshëm për nivele të ndryshme të qeverisjes?)

2. Cilat janë vështirësitë kryesore në procesin e konsolidimit në çdo nivel të qeverisjes? (p.sh., vonesa në dërgimin e informacioneve të njësive të mbuluara, homogjenizimi i politikave kontabël të njësive të cilat zbatojnë korniza të ndryshme rregullatore, identifikimi dhe eliminimi i veprimeve reciproke, mes të tjerash)

3. Cilat janë masat që ka vënë në zbatim secili nivel i qeverisjes për t'u bërë ballë vështirësive të identifikuar në pyetjen e mëparshme? (p.sh., udhëzime, plan i unifikuar kontabël, formim, mes të tjerash)

## **Pjesa 2: procesi i përpilimit të statistikave të financave të sektorit të qeverisjes së përgjithshme dhe sektorit publik**

4. Si kryhet procesi i përpilimit të statistikave financiare të qeverisjes së përgjithshme dhe sektorit publik në çdo nivel të qeverisjes?  
Ju lutemi, mendoni për aspektet e mëposhtme:
  - a. Njësia përgjegjëse për kryerjen e procesit të përpilimit.
  - b. Objekti i përpilimit (p.sh., qeverisja e përgjithshme, qeverisja në nivel qendror/shteti/vendor, buxhetore, jashtëbuxhetore, fondet e sigurimeve shoqërore, shoqëritë publike financiare/jofinanciare, sektori publik etj.)

- c. Korniza statistikore e përdorur (p.sh., GFSM/ESA/SNA)
  - d. Të dhënat e nevojshme për kryerjen e procesit (p.sh., pasqyrat financiare, raportet e tjera financiare, anketa etj.)
  - e. Përshkrim hap pas hapi i procesit të përpilimit.
  - f. Instrumentet informatike të përdorura për kryerjen e procesit
5. Cilat janë vështirësitë kryesore në procesin e përpilimit në çdo nivel të qeverisjes? (p.sh., ndryshimet e klasifikimit sektoriale ose strukturës së një njësie institucionale, veprime rregullimi të ndërlikuara të nevojshme dhe riorganizim i transaksioneve: devijimi/ndarja/ricaktimi, identifikimi dhe eliminimi i transaksioneve të brendshme, vonesa në dërgimin e informacionit të njësisë institucionale të përpiluar, mes të tjerash)
  6. Cilat janë masat të cilat ka vënë në zbatim secili nivel i qeverisjes për t'u bërë ballë vështirësive të identifikuar në pyetjen e mëparshme? (p.sh., organet statistikore që ndjekin ndryshimet në klasifikimin sektorial dhe strukturën e njësisë institucionale, udhëzime, plan kontabël të harmonizuar me statistikatat financiare qeveritare, formim, mes të tjerash)



# SHTOJCA

## 2

# SINTEZA E PËRVOJAVE NDËRKOMBËTARE PËR PËRVIJIMIN E OBJEKTIT TË KONSOLIDIMIT DHE PËRPILIMIT

Tabela 3. Konsolidimi në nivel qendror

	Brazili	Gjeorgjia	Spanja	Zvicra
Qasja për përvijimin e objektit	Ligjore	Ligjore	Kontrolli	Kontrolli
Korniza e përdorur	SNKSP, tërthorazi	SNKSP, tërthorazi	SNKSP, tërthorazi	SNKSP, drejtpërdrejt
Lista e njërive				
Fondet e sigurimeve shoqërore	Po	Po, nëse kontrollohet nga shteti ose një nënnjësi e shtetit (p.sh., nga ministri)		
Banka qendrore	Po	Jo	Jo	Jo
Ndërmarrje me kapital të përzier (qeveria zotëron <50%)	Jo	Jo, por zbatohet SNKSP 36	Jo	Jo, por zbatohet SNKSP 36



	Brazili	Gjeorgjia	Spanja	Zvicra
NSH (qeveria zotëron >= 50%)	Po, nëse nuk është krijuar tregu dhe kontrollohet nga shteti ose një nën njësi e shtetit (p.sh., nga ministri). Krijuesit e tregut paraqiten me metodën e kapitalit neto	Po, nëse nuk është krijuar tregu dhe kontrollohet nga shteti ose një nën njësi e shtetit (p.sh., nga ministri)	Po, nëse kontrollohet nga shteti ose një nën njësi e shtetit (p.sh., nga ministri)	
Universitetet	Po	Po	Po, nëse kontrollohet nga shteti ose një nën njësi e shtetit (p.sh., nga ministri)	
Njësitë e qeverisjes në nivel shteti	Jo në pasqyrat financiare të qeverisë federale, por po në pasqyrat financiare të sektorit publik	Nuk zbatohet	Jo	Jo
Njësitë e qeverisjes vendore	Jo në pasqyrat financiare të qeverisë federale, por po në pasqyrat financiare të sektorit publik	Jo, por paraqiten si shtojcë	Jo	Jo
Ministritë (ndonjëherë të quajtura sekretariate ose departamente), përfshirë njësi të decentralizuara pa personalitet juridik	Po	Po	Po	Po
Njësi të decentralizuara me personalitet juridik (p.sh., agjenci)	Po	Po	Po	Po
Parlamenti e të tjera njësi të legjislativ	Po	Po	Po	Po
Njësitë e gjyqësorit	Po	Po	Po	Po

**Tabela 4. Përpilimi**

	Brazili	Gjeorgjia	Spanja	Zvicra
Qasja për përvijimin e objektit	Sektori i qeverisjes së përgjithshme (SQP) dhe nënsektorët e tij			
Korniza e përdorur	GFSM 2014	GFSM 2001/2014	ESA 2010	HRM2, GFSM 2014 dhe ESA 2010

	Brazili	Gjeorgjia	Spanja	Zvicra
<b>Lista e njësive</b>				
Fondet e sigurimeve shoqërore	Po, brenda SQP-së si pjesë e nënsektorit (pra, nënsektorët e qeverisjes në nivel federal, shteti ose vendor) që integron	Nuk zbatohet	Po, brenda SQP-së si një prej nënsektorëve të tij	
Banka qendrore	Jo, sepse është shoqëri financiare publike dhe sektori publik si i tërë dhe nënsektorët e tij nuk përpilohen			
Ndërmarrje me kapital të përzier (qeveria zotëron <50%)	Jo, sepse janë shoqëri financiare ose jofinanciare			
NSH (qeveria zotëron >= 50%)	Po, nëse është jo krijues tregu. Nëse është ky rast, njësia paraqitet brenda SQP-së si pjesë e nënsektorit (pra, nënsektorët e qeverisjes në nivel qendror/federal, shteti ose vendor) që integron. Nëse njësia është krijues tregu, nuk paraqitet në statistikat financiare qeveritare sepse nuk përpilohet sektori publik si i tërë dhe nënsektorët e tij			
Universitetet	Po, brenda SQP-së si pjesë e nënsektorit (pra, nënsektorët e qeverisjes në nivel qendror/federal, shteti ose vendor) që integron			
Njësitë e qeverisjes në nivel shteti	Po, brenda SQP-së si një prej nënsektorëve të tij			
Njësitë e qeverisjes vendore	Po, brenda SQP-së si një prej nënsektorëve të tij			
Ministritë (ndonjëherë të quajtura sekretariate ose departamente), përfshirë njësi të decentralizuara pa personalitet juridik	Po, brenda SQP-së si pjesë e nënsektorit (pra, nënsektorët e qeverisjes në nivel qendror/federal, shteti ose vendor) që integron			
Njësi të decentralizuara me personalitet juridik (p.sh., agjenci)	Po, nëse është NSH jo krijuese tregu. Nëse është ky rast, njësia paraqitet brenda SQP-së si pjesë e çdo nënsektori (pra, nënsektorët e qeverisjes në nivel vendor, shteti dhe qendror/federal) që integron. Nëse njësia është krijues tregu, nuk paraqitet në statistikat financiare qeveritare sepse nuk përpilohet sektori publik si i tërë dhe nënsektorët e tij			
Parlamenti e të tjera njësi të legjislativ	Po, brenda SQP-së si pjesë e nënsektorit (pra, nënsektorët e qeverisjes në nivel qendror/federal, shteti ose vendor) që integron			
Njësitë e gjyqësorit	Po, brenda SQP-së si pjesë e nënsektorit (pra, nënsektorët e qeverisjes në nivel qendror/federal, shteti ose vendor) që integron			

# MATERIALET MBËSHETËSE

1. Ball, I. (2020). Reflections on public financial management in the Covid-19 pandemic (Reflektime mbi menaxhimin e financave publike gjatë pandemisë së Covid-19). *Journal of Accounting & Organizational Change*, Vol. 16 Nr. 4, f. 655-662. <https://doi.org/10.1108/JAOC-10-2020-0160>
2. Bergmann, A. (2009). *Public Sector Financial Management (Menaxhimi financiar në sektorin publik)*. Londër: Prentice Hall.
3. De Clerck, S. (2022). Consolidation Practices to Improve Fiscal Reporting (Praktikat e konsolidimit për të përmirësuar raportimin buxhetor). Prezantim në seminarin e përbashkët të komuniteteve e praktikës të Edukimit dhe Raportimit Financiar të Programit PULSAR. Vjenë, 1.12.2022.
4. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). (2014). *Manuali për Statistikat Financiare Shtetërore 2014*. Uashington, D.C.: FMN.
5. Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP). (2022). *Handbook of International Public Sector Accounting Pronouncements (Manual i Standardeve Ndërkombëtare mbi Kontabilitetin në Sektorin Publik)*. Nju Jork: Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve.
6. Banka Botërore. (2019). *Benchmarking Guide: Integrating Public Sector Accounting and Government Finance Statistics (Udhëzues krahasimi: integrimi i kontabilitetit të sektorit publik dhe statistikave financiare shtetërore)*. <https://cfr.worldbank.org/publications/benchmarking-guide-integrated-psa-and-gfs>

PROGRAMI  
PULSAR

MENAXHOHET NGA:




**CFRR**   
Centre for Financial  
Reporting Reform



BASHKËFINANCOHET NGA:

 Federal Ministry  
Republic of Austria  
Finance

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
**State Secretariat for Economic Affairs SECO**